



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 11 regjistër (JR)
Datë 18.02.2020

Nr. 16 i vendimit
Datë 26.05.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 26.05.2022, ditën e enjte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 11/2020, datë 18.02.2020, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 222, datë 12.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63, 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenet 46, 47 e 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet në seancë gjyqësore publike prej saj dhe prej avokates Brikena Cufe, të cilat kërkuan përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Durrës. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:
 - 3.1. ILDKPKI-ja¹, pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 3.2. DSIK-ja², pas kryerjes së procedurës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani.*

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 1.03.2018, ka përcjellë pranë Komisionit raportin lidhur me deklaramet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani.

² DSIK-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 2.11.2017, raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, njoftuar deklarifikimi i plotë i tij me shkresën nr. {***} prot., datë 02.08.2019.

3.3. KLD-ja ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, mbi bazë të një hetimi të thelluar e të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 222, datë 12.12.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 222, datë 12.12.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, me detyrë në gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 4, shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

6.1. Për kriterin e kontrollit të figurës, *Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.*

6.2. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, *nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika në aspektin procedural, për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

6.3. Në vlerësimin tërësor të çështjes, *Komisioni, mbështetur në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

7. Kundër vendimit 222, datë 12.12.2019, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore⁴, duke kundërshtuar përfundimet e Komisionit si të pambështetura në dispozitat

³ KLD-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. {***}, datë 10.06.2018, raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani.

⁴ Vendimi i arsyetuar i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 29.01.2020, Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 29.01.2020 dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 28.01.2020. Ndaj tij është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit në datën 11.02.2020, i cili, si ankim jo i plotë, nuk u pranua nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 11.02.2020. Vendimi nr. {***}, datë 11.02.2020, i Komisionit “Për mospranimin e ankimit”, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 12.02.2020, Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 11.02.2020 dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 11.02.2020. Subjekti i rivlerësimit

kushtetuese dhe ligjore, të arritura në kushtet e mosmarrjes në konsideratë dhe të mosvlerësimit të drejtë dhe ligjor të provave të depozituara prej saj gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës, si dhe të pabazuara në provat e administruara.

8. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, paraqiti disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, nenet 47 e 51 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Riçeljen e hetimit gjyqësor.*
 - *Marrjen në shqyrtim të provave me dëshmitarë, ku të pyeten në cilësinë e dëshmitarit shtetasi M. N, si administrator, përfaqësues ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe shtetasi Dh. D, ortak dhe bashkëpunëtor i kësaj shoqërie.*
 - *Marrjen në shqyrtim të provave të reja shkresore.*
 - *Të realizohet këqyrja e drejtpërdrejtë prej trupës gjyqësore, por edhe me ekspertë të saj, mbi arredimin e pasurisë së paluajtshme, të llojit apartament me sipërfaqe 111 m², të ndodhur në lagjen “{***}” Berat, me numër pasurie {***}, zona kadastrale {***}, pronë e regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish-ZVRPP) Dega Vendore Berat, në volumnin {***}, faqe {***}.*
 - *Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
 - *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 222, datë 12.12.2019.*
 - *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*
9. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

9.1 Komisioni duhej të udhëhiqej nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, sikundër detyron neni 52, paragrafi i parë i ligjit nr. 84/2016, pasi, sipas saj, nga vlerësimi i provave, burimi i krijimit të pasurive arin një nivel të kënaqshëm besueshmërie, deklarimet janë të sakta dhe nuk ka fshehje të pasurisë.

9.2 Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), për shkak se: (i) subjekti nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, pasi i njëjti trupi gjyqësor ka hetuar kryesisht në lidhje me pasurinë, ka çmuar provat dhe më pas ka dhënë vendimin; (ii) nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, nuk ka respektuar kërkesat e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative për vlerësimin e provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit para dhe gjatë seancës dëgjimore, duke i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar, për të prapësuar dhe paraqitur kundërgjegje në lidhje me konstatimet e duke e kthyer seancën dëgjimore në seancë tërësisht formale; (iii) janë kryer shkelje procedurale në mënyrën si janë marrë provat në hetimin administrativ; (iv) është cenuar parimi i barazisë para ligjit, duke vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016; (iv) subjekti i rivlerësimit është vendosur në

*në datën 12.02.2020 ka plotësuar të metat e ankimit dhe, në vijim, ankimi është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 12.02.2020.*

pozita diskriminuuese si rrjedhojë e mbajtjes së standardeve të dyfishta në raste të ngjashme dhe e standardeve të ndryshme për sa i përket kuptimit dhe vlerësimit për qëllimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

9.3 Komisioni ka cenuar qëllimin e ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës, duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkluzioni në lidhje me pasurinë, nuk qëndron në raport me figurën, moralin dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

9.4 Vendimi i Komisionit, në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, është i njëanshëm, tërësisht alogjik, i paarsyetuar, jokohorent, i pabazuar në provat e depozituara nga subjekti gjatë gjithë procesit, vlerësimi i kriterit të pasurisë është tendencioz dhe gjetjet janë të pabazuara në analizë financiare.

10. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1 Lidhur me pasurinë apartament, me sipërfaqe 111 m², nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, lagjja “{***}”, në qytetin e Beratit:

10.1.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për *deklarim të pasaktë në deklaratën “vetting” se kredia në shumën 20.000 euro ka pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie*, me pretendimin se me prova të plota dhe të pakundërshtueshme, është provuar qëllimi i kredisë në Alpha Bank për blerje apartamenti, dhe shlyerja e plotë çmimit të shitjes së pasurisë pas marrjes së kredisë, sipas dakordësisë me palën shitëse shoqërinë “{***}” ShPK.

10.1.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për *deklarim të pamjaftueshëm për shkak të mospërputhjeve të rezultuara midis deklaramit të subjektit në deklaratën “vetting”, se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në shumën 20.000 euro dhe pagesave të kryera përpara disbursimit të saj në shumën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe pas disbursimit të kredisë në shumën 14.890 USD, ose rreth 13.000 euro*, me pretendimin se data e mandatit të arkëtimit nr. {***} është plotësuar gabim nga nëpunësi i shoqërisë, dhe vlera 6.610 USD e pasqyruar në këtë mandat, është shlyer pas disbursimit të kredisë.

10.1.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për *mungesë financiare në vlerën 1.546.623 lekë për të blerë këtë pasuri*, me pretendimin se nga vetë analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1998 - mars 2003, rezulton me mjaftueshmëri financiare në vlerën 1.454.000 lekë.

10.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për *deklarim të pamjaftueshëm në vitin 2006 për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, duke pretenduar se ky konkluzion vjen: 1) për shkak të interpretimit të gabuar nga Komisioni të shkresave të administruara nga OTP Bank dhe vlerës së vendosur në zërin “shpenzime për arredim”, vlerë të cilën subjekti e pretendon 69.000 lekë; 2) përfshirjes së shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit në Stamboll, Turqi, në datat 24 - 27.08.2006, duke pretenduar se ky udhëtim ka qenë një vizitë pune dhe shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët.*

10.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionet e Komisionit për *mungesë financiare për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2005*, me pretendimin se këto konkluzione vijnë për

shkak të interpretimit të gabuar nga Komisioni të shkresave të administruara nga OTP Bank, dhe për mungesë financiare për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2012, me pretendimin se metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve të qëndrimit jashtë vendit nuk është e saktë.

10.4 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm për pasurinë apartament me sipërfaqe 110,9 m² + garazh, në {***}/Tiranë, me pretendimin se pasaktësia në deklaratën vetting lidhur me vlerën e kësaj pasurie, është për shkak të gabimit njerëzor, të një harrese e cila nuk sjell asnjë pasojë.

- 11.** Shkaqet e ankimit për vlerësimin e kriterit profesional, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konstatimet e Komisionit se gjyqtarja shfaq probleme në drejtim të procedurës së parashikuar në ligjin 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, duke pretenduar se për shkak të numrit të madh të dosjeve, ishte e vështirë të gjente zbatim procedura e ligjit të sipërpërmendur, dhe për mungesë objektiviteti në këtë vlerësim, pasi si gjyqtare është vlerësuar dy herë “shumë mirë” nga KLD-ja (sot KLGj).

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 12.** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

- 13.** Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 14 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

- 14.** Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e

çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi për shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 222, datë 12.12.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”) në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në datat 20.04.2022 dhe 22.04.2022.

15. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve dhe kërkesës së subjektit të rivlerësimit për interpretim të drejtë dhe ligjor të dokumenteve, pjesë e praktikës së kredisë në Alpha Bank, konstatoi se në fashikujt e Komisionit, dokumentacioni i kësaj kredie ishte përcjellë nga Alpha Bank përmes postës elektronike, i pashoqëruar me shkresë përcjellëse me ekstremitetet përkatëse (numër protokollit e datë), në *e-mail* nuk referohej lista e dokumenteve të përcjella, si dhe në to nuk përfshiheshin disa dokumente të paraqitura nga subjekti me ankimin si pjesë e praktikës bankare të kredisë. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, vendosi të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Trupi gjykues i Kolegjit e mori këtë vendim me qëllim konstatimin e plotë të situatës faktike dhe përsëritjen e marrjes së provës për sa i përket praktikës së kredisë bankare, marrë në Alpha Bank në vitin 2003 nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj. Dokumentacioni i ardhur në Kolegj më datë 29.04.2022 nga Alpha Bank, në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues⁵, iu përcoll subjektit të rivlerësimit⁶.
16. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, paraqiti bashkëlidhur ankimit, materialeve bashkëlidhur parashitave të saj, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye bazuar në parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues për kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

16.1. Subjekti i rivlerësimit paraqiti bashkëlidhur ankimit aktet: (i) “Raport vlerësimi me objekt “Vlerësimi i pajisjeve me të cilat është arreduar apartamenti me nr. pasurie {***}, {***}, me sipërfaqe 111 m², Berat”⁷, për të provuar lidhur me vlerën e arredimit të apartamentit; (ii) ekstrakt nga regjistri tregtar dhe ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhëna të subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, vërtetim nr. {***}, datë 28.02.1992, të Gjykatës së Rrethit Berat, për të provuar lidhur me administratorin dhe ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK; (iii) shkresën e noteres N. D, për të provuar mënyrën e kalimit të shumës së shitjes së pasurisë apartament në Berat, nga pala blerëse te pala shitëse përpara daljes së udhëzimit 6915/2, datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë e noterit”; (iv) deklaratat noteriale të administratorit dhe ortakut të shoqërisë “{***}” ShPK, përkatësisht z. M. N dhe z. Dh. D, për të provuar marrëdhënien e mirëbesimit për realizimin e kontratës së shitjes së apartamentit në Berat në vitin 2003, si dhe deklaratën e z. Sh. Ç, për të provuar mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit

⁵ Shkresa e kryesueses së trupit gjykues, drejtuar Bankës Alpha, nr. {***} regj., datë 26.04.2022.

⁶ Shkresa e kryesueses së trupit gjykues, drejtuar subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nr. {***} regj., datë 16.05.2022, konfirmuar marrja e saj me nënshkrim, datë 18.05.2022.

⁷ Përpiluar më datë 07.02.2020, nga ing. A. Sh, nr. licence NUIS {***} për vlerësim në fushën “Linja teknologjike, makineri e pajisje”.

të bashkëshortit në Turqi në vitin 2006, të cilat u analizuan sipas qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, se megjithëse të vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e tyre provuese në këtë proces është e dobët pasi deklaratat janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe krijojnë perceptimin se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit⁸; (v) fotokopje të shtatë mandatarëkëtimeve të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, të cilat rezultojnë të administruara në fashikujt e Komisionit; (vi) dokumente të praktikës së Alpha Bank, disa prej të cilave të administruara në fashikujt e Komisionit, dhe disa të paraqitura për herë të parë, fotokopje, për të cilat subjekti nuk qartësonte në ankim mënyrën si i ka siguruar; (vii) procesverbali nr. {***}, datë 30.12.2019, i Gjykatës Administrative Durrës, për të provuar se problemet për zbatimin e procedurës sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së çështjeve për këtë periudhë.

16.2. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit të cilat ishin pjesë e fashikullit të Komisionit, si dhe ekstraktet me të dhëna për shoqëritë tregtare të cilat janë të aksesueshme përmes faqes zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit, i vlerësoi të panevojshme si prova, për rrjedhojë vendosi të mos i pranojë ato me këtë cilësi. Aktet e tjera, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, i vlerësoi të papërshtatshme dhe të panevojshme e, për rrjedhojë, vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës.

16.3. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur parashtrësive të datës 01.04.2022, paraqiti si provë 28 fotografi familjare në ambientet e brendshme të apartamentit. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se fotografitë janë paraqitur nga subjekti në një moment kur ligji procedural lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve, për rrjedhojë, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, vendosi të mos i pranojë këto fotografi në cilësinë e provës.

17. Sa i përket kërkesës së subjektit për marrjen e provës me dëshmitarë, konkretisht, dëgjimin e z. M. N, administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, dhe z. Dh. D, ortak i kësaj shoqërie, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi bazuar në përcaktimet e nenit 233, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, për të lejuar provën me dëshmitarë me qëllim të provuarit e faktit, kërkohet bashkëzistenca e dy elementeve, një marrëdhënie e posaçme dhe mungesë e aktit të shkruar. Shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i saj z. M. N, dhe personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nuk rezultojnë të kenë një marrëdhënie të posaçme, për shkak të së cilës të pretendojnë dhe në mënyrë të arsyeshme të pranohet se nuk është nënshkruar një akt i shkruar prej tyre, përkundrazi provohet se palët me vullnet të lirë kanë nënshkruar përpara noterit kontratën e shitblerjes së apartamentit në Berat, kontratë e cila ka prodhuar efektet dhe nuk është kontestuar prej tyre përpara procesit të rivlerësimit. Në këtë situatë faktike, kërkesa e subjektit kualifikohet jashtë sferës së rasteve që rregullon dispozita e sipërcituar, dhe rezultojnë si një përpjekje për të rregulluar apo ndryshuar me dëshmi përcaktime kontraktuale të kontratës të zbatuar ndërmjet palëve dhe të pakontestuar prej tyre përpara procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 49, paragrafi 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të papërshtatshme dhe të panevojshme marrjen e provës me dëshmitarë.

⁸ Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 11/2019 (JR), nr. 34/2019 (JR), nr. 23/2020 (JR), nr. 11/2021 (JR) dhe nr. 5/2022 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

18. Për kërkesën për këqyrje të drejtpërdrejtë prej trupës gjyqësore, por edhe me ekspertë të saj, mbi arredimin e pasurisë së paluajtshme, të llojit “apartament” 2+1, me sipërfaqe 111 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Berat, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerësoi se, përmes këqyrjes apo aktekspertimit, nuk do të mund të qartësohej nëse arredimi i apartamentit është i njëjtë si në periudhën 2002 - 2006, periudhë e deklaruar nga subjekti se është kryer arredimi dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 49, paragrafi 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e vlerësoi të papërshtatshme marrjen e kësaj prove.
19. Në seancën gjyqësore publike të datës 23.05.2022, trupi gjyqësor i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore të Bankës Alpha, sipas listës që depozitoi subjekti i rivlerësimit në këtë seancë, duke i bërë ato pjesë të fashikullit të gjykimit të kësaj çështjeje. Gjithashtu, trupi gjyqësor i Kolegjit administroi në cilësinë e provës edhe aktet e përcjella nga Alpha Bank në zbatim të vendimit të ndërmjetëm⁹.

B. Vlerësimi i trupit gjyqësor të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

20. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni duhej të udhëhiqej nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, sikundër detyron neni 52, paragrafi i parë i ligjit nr. 84/2016, pasi nga vlerësimi i provave burimi i pasurive arin një nivel të kënaqshëm besueshmërie, deklarimet janë të sakta dhe nuk ka fshehje të pasurisë, trupi gjyqësor i Kolegjit vëren se:

20.1. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se për vlerësimin e kriterit të pasurisë është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm administrativ, duke mbledhur informacion nga institucionet qendrore dhe vendore, publike dhe private, sikundër edhe përmes akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, dhe shpjegimeve të dhëna prej saj gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore. Komisioni, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i çdo rrethane dhe fakti, ka krijuar mundësitë për përcaktimin e së vërtetës procedurale dhe marrjen e vendimit në respektim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Dispozitat kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 84/2016 parashikojnë aplikimin nga organet e rivlerësimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit duke synuar që në procesin e rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara, e bazuar vetëm në standarde objektive, në proporcion me shkeljet e konstatuara, dhe duke u siguruar që të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit. Komisioni, në ushtrim të kompetencave të veta për vlerësimin e provave, dobishmërinë dhe rëndësinë e tyre provuese, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit për kriterin e pasurisë ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, për kriterin e kontrollit të figurës ka arritur nivel të besueshëm, ndërsa për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në përputhje me parimin e objektivitetit, ka vlerësuar se mangësitë profesionale të konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal të kualifikimit. Konkluzionet e Komisionit për pasaktësi dhe pamjaftueshmëri të deklarimeve të subjektit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, të parashikuara në nenin 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, janë shkaqe që çojnë në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e këtij ligji. Trupi gjyqësor i Kolegjit do të arsyetojë dhe konkludojë në vijim lidhur me këtë shkak ankimi nëse gjen vend aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

⁹ Përcjellë nga Alpha Bank me shkresën nr. {***} prot., datë 28.04.2022, administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 29.04.2022.

21. Në lidhje me shkakun e ankimit se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi e njëjta trupë gjyquese e KPK-së ka hetuar kryesisht në lidhje me pasurinë, ka çmuar provat dhe më pas ka dhënë vendimin për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

21.1. Kolegji në praktikën e tij gjyqësore, në bazë dhe interpretim të Kushtetutës dhe përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar dhe vlerësuar se në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces i nisur kryesisht, kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit janë të njohura nga Kushtetuta dhe detajohen nga ligji nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se kompetencat kushtetuese dhe ligjore të institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit i janë nënshtruar analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, duke u vlerësuar nga Komisioni i Venecias¹⁰ dhe nga Gjykata Kushtetuese¹¹, si dhe nga GjEDNj-ja për zbatimin praktik të tyre¹². Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe nuk qëndron.

22. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni ka vepruar në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

22.1. Parimi i prezumimit të pafajësisë gjen zbatim në procesin gjyqësor penal, ndërsa procesi i rivlerësimit ka karakter administrativ dhe bazohet në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas rastit, në procedurat e parashikuara në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Megjithatë, në një këndvështrim të gjerë, respektimi i së drejtës për t’u prezumuar i pafajshëm, si një e drejtë me karakter *erga omnes*, ndalon shprehjet apo deklaratat kategorike, të qarta, që në mënyrë të padyshimtë të çojnë në konkluzionin për shkelje të dispozitave ligjore (fajësi). Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, procesverbalit të seancës dëgjimore, pyetësorëve dhe të gjithë komunikimit të kryer me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidenton të dhëna që anëtarët e trupit gjykues të Komisionit të kenë filluar procesin me ide të paracaktuara, ose të jenë shprehur për vlerësime të fakteve apo rrethanave para dhënies së vendimit përfundimtar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

22.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të barazisë para ligjit, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se ky parim kushtetues, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, përcakton detyrimin që veprimtaria e organeve të rivlerësimit, e cila zhvillohet në kuadër të procesit kushtetues të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe rregullohet nga ligji nr. 84/2016, qëllimi dhe objekti i të cilit përcaktohen në nenet 1 dhe 2 të tij¹³, të trajtojë rastet

¹⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

¹¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017.

¹² Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 307, 308 dhe 317.

¹³ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”, dhe neni 2 i ligjit përcakton: “Ky ligj përcakton: 1. Parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët; 2. Metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit; 3. Organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit; 4. Rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut në procesin e rivlerësimit”.

në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nëse elementet e tyre thelbësore janë të njëjta. Barazia në ligj dhe para ligjit, e trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta¹⁴.

22.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar nën doza të larta paragjykimi, duke mbajtur standarde të dyfishta në raste të ngjashme dhe standarde të ndryshme kuptimi dhe vlerësimi për qëllimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në pozita diskriminuese, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

22.3.1. Procesi kushtetues i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rregullat e posaçme të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, roli dhe kompetencat që ky ligj i njej Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, përbëjnë garanci të plotë për të përmbushur qëllimin dhe objektin e ligjit. Trupi gjykues, nga kontrolli i vendimit objekt ankimi dhe akteve në fashikuj, nuk konstaton qëndrime apo veprime të Komisionit për të cilat mund të ngrihet pretendimi për moszbatim të parimit të paanshmërisë, i cili nënkupton mungesën e paragjykimave ose të anshmërisë. Subjekti i rivlerësimit është njohur me qëndrimet e Komisionit në lidhje me secilin prej kriterëve të rivlerësimit, të shprehur paraprakisht në rezultatet e hetimit administrativ, për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën. Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me ndonjë ndryshim të qëndrimit të Komisionit për çështje të caktuara, krahasuar me praktikën e tij për çështje të ngjashme, ndërsa në ankim ka referuar dhe cituar pjesë të disa vendimeve të Komisionit dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹⁵. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar juridiksionit dhe kompetencës së tij, përcaktuar nga Kushtetuta¹⁶, vlerëson se, edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura, Kolegjit nuk mund t'i atribuohet roli për të krahasuar vendime të Komisionit, dhënë për subjekte të ndryshme, e aq më pak për vendime të dhëna nga struktura të tjera të sistemit të drejtësisë. Kontrolli ligjor i vendimeve të Komisionit nga Kolegji kryhet vetëm nëpërmjet ankimit.

22.3.2. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, kur ai “[...] nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv”, pra kur ai nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet¹⁷. Në kushtet kur Komisioni, në bazë të provave të administruara, ka konstatuar probleme në vlerësimin e kriterit të pasurisë, të klasifikuara sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pretendimet për vendosje të subjektit në pozita diskriminuese duken të tejkaluara. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe në fakte.

¹⁴ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 27.08.1993.

¹⁵ Subjekti ka referuar vendimet e Komisionit nr. 46, datë 24.07.2018, nr. 105, datë 12.02.2019, nr. 49, datë 25.07.2018, nr. 104, datë 07.02.2019, nr. 212, datë 22.11.2019, si dhe vendimin nr. 254, datë 12.11.2019 të KLGj-së.

¹⁶ Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës përcakton se: “5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.

¹⁷ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Karsën dhe të tjerë kundër MB*.

23. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni ka cenuar qëllimin e ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës, duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, përcaktimet e të cilit kërkojnë që, për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, të plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternative dy kriteret: pamjaftueshmëri në kontrollin e figurës dhe të pasurisë, Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij¹⁸. Sipas këtij qëndrimi, leximi harmonik i neneve 61, pika 3, dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, përcakton detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në zbatim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pavarësisht se pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 shprehet për të dyja kriteret, për shkak të drejtimit të qartë që Aneksi i Kushtetutës jep për secilin nga kriteret, nuk mund të argumentohet se deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë duhet të interpretohet në mënyrë kumulative, pra domosdoshmërisht të kushtëzohet me probleme të kontrollit të figurës për të vërtetuar deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe nuk qëndron.
24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, pasi ka kryer shkelje procedurale në mënyrën si ka marrë provat në hetimin administrativ, nuk ka respektuar kërkesat e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos vlerësuar provat e paraqitura prej subjektit, nuk ka vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit para dhe gjatë seancës dëgjimore, duke i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe paraqitur kundërgjegje në lidhje me konstatimet, duke e kthyer seancën dëgjimore të datës 11.12.2019 në seancë tërësisht formale.

24.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, konstaton se janë zbatuar korrektësisht të gjitha detyrimet që parashikon ligji mbi bazën e të cilëve rregullohet veprimtaria hetimore administrative e procesit të rivlerësimit. Konkluzionet e Komisionit për secilën gjetje janë bazuar në arsyetimin dhe vlerësimin ligjor të rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ të zhvilluar përgjatë periudhës 21.05.2018 - 11.11.2019, gjatë së cilës subjektit të rivlerësimit i është garantuar zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor në respektim të plotë të parimit të kontradiktoritetit. Nga aktet në fashikull, rezulton se ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit ka pasur komunikim të rregullt lidhur me dhënien e sqarimeve, informacionit dhe dokumentacionit provues. Subjekti i rivlerësimit është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet dhe të marrë kopje të tyre, i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi administrativ, ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes duke dhënë shpjegime, paraqitur dokumente dhe akte në cilësinë e provave, dhe është dëgjuar në seancën dëgjimore.

24.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni duke mos respektuar nenin C, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 49, pika 9, nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe nenin 183 të Kodit të Procedurës Civile, nuk ka disponuar lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, për marrje të provave që janë kërkuar prej saj pas kalimit të barrës së provës, duke i cenuar të drejtën e ushtrimit të mbrojtjes, trupi gjykues i Kolegjit referon jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese¹⁹, e cila shprehet se: *“mospranimi nga gjykata i kërkesave dhe pretendimeve të palëve nuk do të thotë se atyre u janë shkelur të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Përkundrazi, dëgjimi i pretendimeve të palëve dhe rrëzimi i tyre me*

¹⁸ Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 19/2019; vendimin nr. 1/2021.

¹⁹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 90/2001.

vendim i shërben respektimit të të drejtave për një proces të rregullt ligjor”. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se refuzimi i marrjes së provave ka të bëjë me themelin e çështjes, dhe vlerësimi i tyre është totalisht në diskrecion të Komisionit. Kërkesa e subjektit për marrje të provave është shqyrtuar nga Komisioni në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, dokumentuar nga procesverbali i seancës së zhvilluar më datë 18.11.2019, dhe në përputhje me nenin 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka disponuar këtë kërkesë me vendim të arsyetuar të marrë po më datë 18.11.2019. Pretendimi i ngritur nga subjekti se: *“Komisioni vetëm pas dorëzimit të mbrojtjes ndoshta ka zbardhur dhe arsyetuar vendimin për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti, pasi ka vlerësuar se me anë të kërkesës pretendohet të vërtetohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili dhe po të konsiderohet i vërtetë nuk ndikon në marrjen e vendimit”*, rezultoi i pabazuar në raport me aktet e administruara në fashikujt e Komisionit. Kronologjia e kohës së evidentimit në regjistrin e protokollit të dy akteve shkresore: vendimit të ndërmjetëm të Komisionit më datë 21.11.2019, dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ më datë 22.11.2019, në të kundërt sa pretendon subjekti, dëshmon për pamundësi objektive që zbardhja e vendimit të arsyetuar për refuzimin e kërkesës për marrje të provave të jetë ndikuar nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në njoftimin drejtuar subjektit të rivlerësimit për refuzimin e marrjes së provave nga Komisioni, janë pasqyruar si data 18.1.2019 e zhvillimit të seancës nga trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës së subjektit për marrje të provave, ashtu dhe numri i protokollit dhe data e regjistrimit në zyrën e protokollit të vendimit të ndërmjetëm me të cilin Komisioni ka disponuar kërkesën. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, megjithëse në dijeni edhe të ekstremiteteve të regjistrimit të vendimit të ndërmjetëm, të ketë adresuar kërkesë për vënien në dispozicion të tij, duke krijuar dyshim të arsyeshëm për interesin e saj për t’u njohur me këtë vendim, dhe pabazueshmërinë e pretendimit se *vendimi i zbardhur nuk m’u dha asnjëherë*.

25. Trupi gjykues i Kolegjit, për pretendimin e subjektit, *“se nëse Komisioni, në kuptim të një hetimi të drejtë, do të më kishte njoftuar për rrëzimin e kërkesës për këqyrje të arredimit të apartamentit në Berat, unë do të kisha përgatitur si provë shkresore akt-ekspertimin”*, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk identifikon normat e së drejtës që janë shkelur nga ana e Komisionit sa i përket kohës së njoftimit të vendimit të ndërmjetëm. Referuar nenit 53 të Kodit të Procedurave Administrative, afati procedural i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit dhe, në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit nuk referon arsye përse nuk ka përdorur mjetet procedurale të njohura nga ligji për të kërkuar shtyrjen e afatit për paraqitjen e pretendimeve për hetimin administrativ, apo të ketë shfrytëzuar të drejtën e njohur nga ligji për depozitimin e provave edhe në seancën dëgjimore. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim nga ana e Komisionit të së drejtës së mbrojtjes efektive, mbetet deklarativ dhe i pambështetur në ligj.

25.1. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural më parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Subjekti ka paraqitur pretendimet për rezultatet e hetimit administrativ më datë 22.11.2019. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, rezultoi që nga ana e relatores janë paraqitur në mënyrë të detajuar rezultatet e hetimit administrativ, së bashku me qëndrimet dhe

parashtrimet e subjektit për çdo gjetje, si edhe lidhur me kërkesën e subjektit për marrje të provës me dëshmitarë në mbështetje të pretendimeve për mënyrën e kryerjes së pagesës së vlerës së apartamentit në Berat dhe arsytet e refuzimit të saj nga ana e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, në seancën dëgjimore ka parashtruar të njëjtat deklarime, qëndrime dhe kundërshtime sikundër në pretendimet për rezultatet e hetimit administrativ, nuk ka paraqitur pretendime lidhur me refuzimin e marrjes së provave të kërkuara prej saj apo për disponimin me vendim për kërkesën, si dhe nuk ka kërkuar të depozitohet prova të reja. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, ka pasur mundësinë të kundërshtojë çdo gjetje të Komisionit të relatuar nga ana e relatorit të çështjes, të shpjegojë lidhur me faktet dhe provat e administruara nga Komisioni, si dhe të parashtrtojë çdo kërkesë që ka vlerësuar në interes të mbrojtjes së saj, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin për seancë dëgjimore tërësisht formale.

26. Në lidhje me shkakun e ankimit se vendimi i Komisionit është në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, është i njëanshëm, tërësisht alogjik, i paarsyetuar, jokohorent, i pabazuar në provat e depozituara nga subjekti gjatë gjithë procesit, vlerësimi i kriterit të pasurisë është tendencioz dhe me gjetje të pabazuara në analizën financiare, pasi nuk rezulton asnjë deklaram i pasaktë me qëllim fshehjen e pasurisë, si dhe nuk rezulton të këtë deklaram të pamjaftueshëm.

26.1. Mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese²⁰, e cila bazuar në interpretimin e GjEDNj-së, thekson se respektimi i parimit të paanshmërisë, një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, i cili ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Kriteri i dytë nënkupton se, përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar²¹. Sa i takon vlerësimin subjektiv, GjEDNj-ja i ka qëndruar vazhdimisht parimit se *paanësia personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri në momentin kur provohet e kundërta*²². Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, për sa nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues, të ketë kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari, apo që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë kërkuar të heqë dorë, sipas vlerësimit subjektiv, nuk rezulton të këtë shkak për të cilin të pretendohet për ekzistencë paragjykimi apo qasje personale nga ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit nuk identifikon rrethana konkrete, qëndrime apo sjellje subjektive për anëtarët e trupit gjykues gjatë hetimit administrativ, sipas konceptit të vlerësimit objektiv. Për rjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për njëanshmëri të Komisionit në vendimin e marrë me votë unanime nga anëtarët e trupës, vlerësohet i pabazuar.

²⁰ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 13.04.2007; nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008.

²¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 10.10.2013.

²² GjEDNj - çështja Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës; çështja Micallef kundër Maltës; çështja Driza kundër Shqipërisë.

26.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shqyrtuar provat dhe rrethanat në mënyrë të qëllimshme dhe tendencioze duke synuar të pakësojë të ardhurat e ligjshme të vërtetuara, të shtojë artificialisht shpenzimet për të çuar subjektin drejt shkarkimit për shkak të pamjaftueshmërisë financiare, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, lidhur me përfundimet e hetimit administrativ: për mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë apartament në qytetin e Beratit dhe për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2003; për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta” në vitin 2006; për deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë “apartament” në {***}/Tiranë në vitin 2009; për deklaram të pamjaftueshëm të shpenzimeve për arredimin e apartamentit në Berat, të kryer përgjatë periudhës 2002 - 2006; për mungesë financiare për të përballuar shpenzimet familjare në vitet 2005 dhe 2012, dhe subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën. Shqyrtimi, analiza e fakteve dhe provave të mbledhura nga Komisioni në mënyrë të integruar me shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, gjatë hetimit administrativ, dhe i provave të paraqitura prej saj në përmbushje të barrës së provës, vlerësimi i tyre duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të objektivitetit, bën që pretendimi për tendencë nga ana e Komisionit të jetë i tejkualuar.

26.3. Kuadri ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit, përcakton në mënyrë shteruese mjetet për kërkimin e provës, me qëllim të vërtetuarit të rrethanave dhe fakteve apo të bazueshmërisë së pretendimeve të palëve në proces. Referuar përcaktimeve të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, legjislatori, në funksion të realizimit të qëllimit për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, ka përcaktuar edhe për formë të tjera të fiksimit të të dhënave, të cilat shërbejnë si indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, çmuarja dhe vlerësimi i të cilave është diskrecion i organeve të vlerësimit, bindjes së brendshme që këto organe krijojnë lidhur me to. Në vendimin objekt ankimi, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, çdo gjetje dhe konkluzion i Komisionit është i bazuar në analizë financiare të kryer mbi bazën e vlerësimit të dokumenteve të administruara, dhe të dhënave të përfuara prej tyre. Komisioni, me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me mospërputhjet e konstatuara për vlerën e arredimit të apartamentit në Berat, për të cilin subjekti kishte deklaruar në pyetësorë shumë 321.000 lekë, përkundrajt vlerës prej 2.030.000 lekësh, të pasqyruar në praktikën e kredisë bankare të përfuar në vitin 2009 në Bankën Popullore. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, me pretendimet për rezultatet e hetimit administrativ, ka dorëzuar në Komision përgjigjen e Bankës OTP²³. Komisioni, në analizë të integruar të dokumenteve të praktikës së kredisë bankare, me informacionin e dhënë nga OTP Bank, ka analizuar se pavarësisht alternativës së përdorur nga nëpunësit e bankës, intervistimin me klientin (subjektin dhe bashkëshortin e saj), apo vlerësimin e arredimit sipas çmimeve të tregut, reflektohen vlerat e orendive në vitin 2009, orendi të cilat rezultojnë pothuaj të njëjta me ato të deklaruara nga subjekti, dhe për nga përlllogaritja kohore, viti është i përafërt me vitet e deklaruara nga subjekti për kryerjen e arredimit. Bazuar në këtë analizë, duke vlerësuar se në çdo rast të zbatuar për vlerësimin e arredimit, pasoja është e evidente dhe konfirmon shumë e pasqyruar në dokumentet e bankës, Komisioni ka konkluduar se shpenzimi për arredimin e pasurisë është në vlerën 2.030.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se normat kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit kërkojnë që organet e rivlerësimit, në këtë rast Komisioni, të mos kufizohen në informacionet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit,

²³ Shkresa e Bankës OTP, në përgjigje të kërkesave të subjektit nr. {***} prot., datë 14.11.2019, drejtuar Bankës OTP, Dega Berat; nr. {***} prot., datë 18.11.2019, drejtuar OTP Tiranë; e-mail i datës 21.11.2019.

por të kërkojnë çdo informacion dhe provë të nevojshme për marrjen e një vendimi në përputhje me qëllimin e vetë ligjit. Fakti që deklarimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nuk janë vlerësuar nga Komisioni në mënyrën e dëshiruar prej saj, nuk do të thotë se ka munguar vlerësimi lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor. Në këtë rast, vlerësimi i trupit gjykues vjen në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit kur në shqyrtimin e vendimeve të tjera të Komisionit, është konstatuar e njëjta situatë²⁴.

26.4. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, për vlerësim tendencioz për kriterin e pasurisë nga ana e Komisionit, pasi sipas saj nuk rezulton të jetë konstatuar asnjë deklaram i pasaktë me qëllimin e vetëm fshehjen e saj, si dhe nuk rezulton të këtë deklaram të pamjaftueshëm, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se bazuar në situatën faktike dhe ligjore, ku subjekti ka dështuar të provojë lidhur me saktësinë e deklarimeve të saj dhe mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, pretendimi për vlerësim tendencioz për kriterin e pasurisë nga ana e Komisionit, vlerësohet i pabazuar në ligj.

26.5. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se vlerësimi i provave nga Komisioni përpara dhënies së vendimit përfundimtar, mund të shihej prej subjektit si paragjykim i çështjes. Në vendim, Komisioni analizon dhe jep vlerësimet përfundimtare lidhur me faktet, provat, në përputhje me përcaktimet e nenit 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, në vendim, ka referuar deklarimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, provat e paraqitura prej saj, duke i analizuar ato në raport me provat e tjera të administruara. Nga analiza e përmbajtjes së vendimit, për secilën pasuri të hetuar, në seksionin “Analiza e provave dhe e fakteve”, konstatohet pasqyrimi i plotë i dokumentave të depozituara nga subjekti në fazën e parë të procesit të rivlerësimit, vlerësimi i Komisionit në raport me provat e tjera të administruara dhe përfundimet për të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës. Në vijim, në seksionin “Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni”, Komisioni ka parashtruar arsyetimin dhe vlerësimin ligjor të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në raport me provat e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ, në përputhje të plotë me sa përcakton neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative²⁵.

26.6. Në lidhje me vendimin e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson plotësimin e kërkesave të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj se: *Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese.* Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, se në vendimin e Komisionit nuk përcaktohen dispozitat ligjore ku mbështet nxjerrja e përfundimeve, duke mos përmbushur detyrimin që për çdo pikë të ngritur në vendim si shkak shkarkimi nga detyra, të shprehet edhe për dispozita ligjore ku bazohej, duke provuar edhe shkeljen konkrete të ligjit material e procedural të kryer nga ana e saj, vlerësohet në raport me përcaktimet e nenit 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit duhet të përmbajë: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe

²⁴ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nr. 5/2019(JR), nr. 13/2019 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR).

²⁵ Neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. Në vendimin e Komisionit, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, për cilëndo nga pasuritë e hetuara, janë përmbushur të gjitha urdhërimet ligjore të sipërcituara, përfshirë edhe dispozita përkatëse ku është bazuar konkluzioni i Komisionit për secilin rast.

26.7. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku gjykata është shprehur se *neni 6/1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument*²⁶, pretendimi i subjektit se vendimi është i paarsyetuar, jokohorent, me mungesë përfundimesh logjike vlerësohet i pabazuar, dhe lidhet me vlerësimin që Komisioni u ka bërë shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej saj, në raport me faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, dhe në vlerësimin tërësor të çështjes bazuar në kërkesat ligjore. Komisioni, pas përmbylljes së një faze të plotë të hetimit administrativ, gjatë të cilit subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë cenim të së drejtës procedurale për të paraqitur shpjegime, pretendime dhe prova, duke zbatuar normat ligjore që lidhen me të provuarit për gjendjen e fakteve dhe rrethanat e çështjes, bazuar në parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe objektivitetit, ka analizuar themelin e çështjes dhe, me vendim përfundimtar të arsyetuar dhe të mbështetur në dispozitat materiale të ligjit nr. 84/2016, u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit garanton që ushtrimi i funksioneve nga institucionet e rivlerësimit të bëhet mbi bazën e pavarësisë, paanësisë, barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton që pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, për këtë shkak ankimi, lidhen me kundërshtimin për mënyrën si Komisioni ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura prej saj dhe si ka vlerësuar në tërësi rrethanat e faktit lidhur me kriterin e pasurisë. Për më tej, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit mbi bazën e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, respektimi i parimeve të paanësisë dhe pavarësisë garantohej nga gjykimi efektiv në Kolegji. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar në ligj.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

*Për pasurinë apartament, me sipërfaqe 111 m², lagjja “{***}”, në qytetin e Beratit*

27. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit (i) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.546.623 lekë për të blerë këtë pasuri dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (ii) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën “vetting” se për blerjen e kësaj pasurie, burim krijimi është kredia në shumën 20.000 euro, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për shkak të mospërputhjeve të rezultuara midis deklaramit të subjektit në deklaratën “vetting” se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në shumën 20.000 euro dhe pagesave të kryera përpara disbursimit të saj në shumën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe pas disbursimit të kredisë në shumën 14.890 USD, ose rreth 13.000 euro; (iii) ka kryer deklaram të pasaktë se kredia në shumën 20.000 euro ka pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të

²⁶ *GjEDNj - çështja Van de Hurk kundër Pays-Bas; çështja García Ruiz kundër Spanjës; çështja Perez kundër Francës.*

kësaj pasurie dhe, për pasojë, në tërësi për këtë pasuri, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

27.1. Nga analizimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting*: *Apartament 111 m², lagjja “{***}”, Berat, vlera 3.000.000 lekë. Krijuar 16.04.2003, sipas kontratës datë 9.04.2003. Burimi: 20.000 euro, kredi në Alpha Bank, dega Berat, sipas kontratës datë 27.6.2003; 300.000 lekë të ardhura nga paga. Rivlerësuar në nëntor të vitit 2011, sipas ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, në vlerën 6.300.000 lekë, paguar 33.000 lekë (1% e vlerës së shtuar). Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklaram pasurie të vitit 2003: apartament 2+1, me sip. 110 m², në vlerën 3.000.000 lekë, me kredi në Alpha Bank në vlerën 20.000 euro, si dhe kursime në vite.*

27.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për *deklaram të pasaktë në deklaratën “vetting” se kredia në shumën 20.000 euro ka pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie*, me pretendimin se me prova të plota dhe të pakundërshtueshme është provuar se qëllimi i kredisë në Alpha Bank ka qenë për blerjen e këtij apartamenti, se shlyerja e plotë e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, në dakordësi dhe mirëkuptim me palën shitëse, shoqërinë “{***}” ShPK, është kryer pas marrjes së kredisë dhe jo në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë.

27.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se burimi i krijimit të pasurisë është kredia e marrë në Alpha Bank*, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht analizoi dokumentacionin e praktikës së kredisë të përcjellë nga Alpha Bank në Kolegj dhe konstatoi se ishte i njëjtë me atë të administruar në fashikujt e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, në çelje të seancës gjyqësore në Kolegj, përmes avokates, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, paraqiti kërkesë paraprake për ripërsëritjen nga Kolegji të kërkesës pranë Bankës Alpha, për marrje të dokumentacionit të kredisë, dhe në rast të refuzimit të kësaj kërkesë, të administrohej dokumentacioni që banka i kishte vënë në dispozicion subjektit më datë 12.05.2022²⁷. Sipas avokates, kjo kërkesë paraprake paraqitej pasi prej subjektit ishte konstatuar se në dokumentacionin e kredisë të përcjellë në Kolegj nga Alpha Bank, krahasimisht me dokumentacionin që banka i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, me kërkesë të saj, mungonin disa dokumente²⁸. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimit e të gjitha fakteve dhe rrethanave, vendosi të pranojë në cilësinë e provës aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore²⁹.

²⁷ Subjekti i rivlerësimit sqaroi se, bazuar në vendimin e ndërmjetëm të trupit gjykues të Kolegjit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim sqarimin e situatës faktike sa i përket kredisë së marrë në Alpha Bank, më datë 26.04.2022, ka përsëritur kërkesën të kjo bankë për vënie në dispozicion të dokumentacionit të kredisë (sipas pretendimit të subjektit kërkesa e parë i është drejtuar prej saj Bankës Alpha më datë 30.01.2020, dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga banka në përgjigje të kësaj kërkesë, ishte paraqitur prej saj bashkëlidhur ankimit).

²⁸ Sipas pretendimit të avokates, në praktikën e kredisë së përcjellë nga Alpha Bank në Kolegj, nuk ishin pjesë: vendim për huadhënie i datës 04.06.2003, letër konfirmimi hua për A. dhe Marjana Velçani të datës 01.07.2003, dhe slipe të disbursimit të huas (7 fletë).

²⁹ Subjekti i rivlerësimit depozitoi: slipe disbursimi të huas, kontratë hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol., vendim për huadhënie nr. {***}, datë 04.06.2003, pasqyrë për vlerësim apartamenti, propozim për fshirje hipoteke, deklaratë noteriale për fshirje hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol., kontratë kredie shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, datë 27.06.2003, shtesë e kontratës së kredisë shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, datë 27.06.2003, marrëveshje shtesë financimi, letër konfirmimi, hua për A. dhe Marjana Velçani, të datës 01.07.2003, dhe kërkesa të subjektit drejtuar Bankës Alpha, depozituar me nr. {***} prot., datë 30.01.2020.

27.4. Trupi gjykues i Kolegjit, në referim të përcaktimeve të nenit 1031 të Kodit Civil³⁰, vlerëson se kontrata e kredisë, shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, datë 27.06.2003, me anë të së cilës Alpha Bank u ka çelur kredimarrësve (bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit), kredinë në shumën prej 20.000 eurosh, po ashtu edhe shtesa e kësaj kontrate, nuk kanë të përcaktuar qëllimin për të cilin është marrë kredia, duke dëshmuar për një marrëdhënie juridike civile mes palëve, me efekte detyruese për bankën e cila është bërë debitorë ndaj kredimarrësve për shumën e akredituar, dhe të drejtën e fituar të kredimarrësve përkundrejt bankës për të përdorur kredinë e dhënë/çelur, marrëdhënie për të cilën banka ka marrë garanci përmes hipotekimit në favor të saj³¹, të pasurisë në pronësi të kredimarrësit (bashkëshortit të subjektit), apartament me sipërfaqe 111 m², në qytetin e Beratit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në seancë, se: *[...] është fakt i njohur, jo vetëm për vitet 2003, por edhe sot, që bankat kërkojnë detyrimisht që para lëvrimit të kredisë të vendosej si garanci hipotekore vetë banesa për të cilën do të lëvrohej kredia, duke imponuar kështu detyrimisht lidhjen e kontratës së blerjes së pasurisë së paluajtshme/ banesës para lidhjes së kontratës së lëvrimit të kredisë, pra që veprimi juridik i blerjes së pronës të paraprinte atë të lëvrimit të kredisë [...]*, nuk gjen relevancë sepse banka nuk mund të imponojë për kredimarrësin lidhjen e një kontrate shitblerjeje, për sa ky është në pamundësi për të realizuar një nga kushtet kryesore të kontratës: shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë. Në dokumentacionin e kredisë të përcjellë në Kolegji nga Alpha Bank, po ashtu edhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në seancë, nuk ndodhet kërkesa e personit të lidhur (bashkëshortit) për përfitim të kredisë në vlerën 20.000 euro, si dhe nuk rezulton ndonjë e dhënë lidhur me datën kur është bërë kjo kërkesë apo dokumentacionin e paraqitur për përfitim të saj në funksion të qëllimit të pretenduar për blerje të këtij apartamenti. Subjekti i rivlerësimit, në seancën në Kolegji, dha sqarime se bashkëshorti kishte paraqitur në bankë kërkesën për kredi me qëllim blerjen e apartamentit me sipërfaqe 111 m², në Berat, së bashku me certifikatën e pronësisë së këtij apartamenti pas datës 15 maj 2003. Në këto rrethana, banka nuk do të ishte në kushtet e shqyrtimit të një kërkesë për blerje apartamenti (në rastin e apartamentit me sipërfaqe 111 m²) për sa nuk kishte asnjë shkak ligjor, të dhënë apo rrethanë tjetër që të vinte në dyshim titullin e pronësisë së kredimarrësit, i cili, me veprime konkludente, përkundrejt bankës, po dëshmonte se gëzonte i qetë tagrat e pronësisë. Marrëveshja shtesë e financimit, lidhur mes palëve në bazë të kontratës së kredisë shërbyer me llogari rrjedhëse nr. {***}, nënshkruar prej tyre përpara noterit, i vetmi dokument i praktikës që përcakton qëllimin e kredisë, sipas përcaktimit të nenit 1: *[...] Huaja jepet me afat prej 15 vjetësh që fillon nga data e parë e disbursimit, me shlyerje me këste tremujore, me qëllim të vetëm blerje dhe rikonstruksion apartamenti [...]*, nuk jep të dhëna rreth apartamentit (vlera, vendndodhja etj.) apo të dhëna për rikonstruksionin (volum/zëra të punimeve etj.). Në kushtet kur në dokumentet e kredisë nuk ka të dhëna lidhur me pasurinë për të cilën Alpha Bank miraton kredinë për blerje apo rikonstruksion, dhe kur kredimarrësi provonte përkundrejt bankës titullin e pronësisë për apartamentin me sipërfaqe 111 m² në Berat, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se qëllimi i kredisë i përcaktuar në marrëveshjen shtesë të financimit për blerje dhe rikonstruksion apartamenti, nuk provohet se ka pasur për qëllim blerjen e këtij apartamenti. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se kredia e marrë në Alpha Bank është burimi i krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 111 m² në Berat, është i pabazuar.

³⁰ Neni 1031 i Kodit Civil jep përkufizimin për hapjen (çeljen) e kredisë bankare, duke përcaktuar: “Hapja e kredisë bankare është një kontratë me të cilën banka detyrohet të mbajë në dispozicion të palës tjetër një shumë parash, për një periudhë të caktuar kohe ose për një kohë të pacaktuar”.

³¹ Kontratë hipoteke nr. {***} rep./nr. {***} kol., datë 27.06.2003.

27.5. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtresat e datës 1.04.2022, ka ngritur pretendimin se Komisioni nuk kishte interpretuar dhe vlerësuar drejt marrëveshjen shtesë të financimit, e cila mban datën 26.03.2003, që sipas subjektit përbën provë të plotë se marrëdhënia me bankën ka filluar kohë përpara nënshkrimit të kontratës së kredisë, duke kërkuar nga Kolegji rishikimin e këtij dokumenti për një interpretim të drejtë dhe ligjor të tij. Nga përmbajtja e këtij dokumenti, në vështrim të krahasuar me përmbajtjen e dokumenteve të tjera të praktikës së kredisë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se marrëveshja shtesë e financimit, pavarësisht datës së pasqyruar në të, 26.03.2003, rezulton të jetë nënshkruar nga kredithënësi (Alpha Bank) dhe kredimarrësit (bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit) në të njëjtën datë me kontratën e kredisë³². Në ndryshim nga sa ka pretenduar dhe kërkuar në ankim, subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegji në datën 26.05.2022, në parashtrimet me shkrim, po ashtu edhe gjatë bisedimeve, deklaroi se data e pasqyruar në marrëveshjen shtesë të financimit, duhet të jetë një lapsus, për sa, sipas përmbajtjes së marrëveshjes, palët kanë rënë dakord për kushtet e përcaktuara në të, pasi Alpha Bank ka çelur *në favor të kredimarrësit shumën prej 20.000 eurosh*, pra në kronologji të kohës nuk ka mundësi objektive që marrëveshja e financimit të lidhej mes palëve përpara nënshkrimit prej tyre të kontratës së kredisë (huas). Në kontekst të qëndrimeve të ndryshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, deklarimeve dhe pretendimeve në Komision, kërtimeve dhe pretendimeve në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka tentuar të shtrembërojë faktet dhe të prezantojë një situatë të ndryshme nga ajo faktike për sa, për veprimin juridik të kryer nga vetë ajo, dëshmuar përmes nënshkrimit, nuk mund të ngrihet pretendimi për pasjen dijeni të kohës së kryerjes së tij vetëm përmes datës të pasqyruar në dokument.

27.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *kontrata e shitblerjes së pasurisë me shoqërinë “{***}” ShPK, më datë 9.04.2009 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.]*, është lidhur dhe realizuar në mirëbesim mes palëve, me qëllim krijimin për palën blerëse (bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit) të kolateralit për përfitim të kredisë bankare për blerjen e pasurisë, dhe për palën shitëse (shoqërinë “{***}” ShPK) realizimin e interesit për marrjen e vlerës së shitjes së pasurisë nga kredia që do të përfitonte pala blerëse, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si vijon:

27.6.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kontrata e shitblerjes e datës 9.04.2009, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se: *Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj*, lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: *Aktet*

³² *Marrëveshja shtesë e financimit lidhur mes Bankës Alpha dhe kredimarrësve (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur), përcakton (i) në hyrje të saj: [...] palët në këtë kontratë [...] ranë dakord dhe pranuan sa më poshtë vijon: në bazë të marrëveshjes së kredisë shërbyer me llogari rrjedhëse {***}, banka (Dega e Beratit) hapi (çeli) në favor të kredimarrësit shumën prej 20.000 euro, e cila mund të disbursohet tërësisht ose pjesërisht [...]; në nenin 8 [...]. Kjo marrëveshje shtesë bashkë me marrëveshjen e kredisë në llogari rrjedhëse nr. {***}, kushtet e së cilës vazhdojnë të jenë në fuqi në atë masë që nuk ndryshohen nga kjo marrëveshje, përbëjnë një të tërë [...]; përmbillet me shënim [...] “Unë noterja pasi ua lexova me zë të lartë përmbajtjen e kësaj kontrate dhe të marrëveshjes shtesë, konstatova se ato vinin në përputhje me qëllimin e tyre dhe pasi palët nënshkruan rregullisht me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në praninë time, unë noterja vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit [...]”. Gjithashtu, në kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.06.2003, lidhur mes Bankës Alfa dhe kredimarrësve (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur), për krijimin e hipotekës në favor të Bankës për pasurinë apartament të regjistruar në ZRPP Berat, në pikën 1.2., përcaktohen aktet ligjore prej nga rrjedhin detyrimet e kredimarrësve kundrejt bankës: “Kontrata e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.06.2003 dhe marrëveshja shtesë e financimit e së njëjtës datë”.*

zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre, përbën provë të plotë se vullneti i deklaruar i palëve përpara noterit ka qenë i pavesuar, i ligjshëm dhe i plotë. Palët kontraktuese në këtë marrëdhënie juridiko-civile të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, apartament me sipërfaqe 111 m², në Berat, me nënshkrimin e kontratës së shitjes me efekt provueshmërie *ad probationem*, kanë marrë garancitë që asnjëra prej tyre të mos derogojë nga obligimet e saj për përmbushjen e detyrimeve, duke dëshmuar se këto garanci nuk mund t'i siguronin vetëm në bazë mirëbesimi. Përmes kontratës së shitjes, pronësia e apartamentit ka kaluar te pala blerëse jo vetëm për arsye subjektive, sikundër pretendon subjekti se palët kanë vepruar në mirëbesim, por edhe për arsyen objektive të transferimit të sendit nga shitësi te blerësi, pasi prej tij është përmbushur detyrimi për të paguar çmimin e shitjes përpara nënshkrimit të kontratës.

27.6.2. Për pretendimin e subjektit se në kontratë nuk ka kushte që mund të kufizonin regjistrimin e pronësisë, për faktin se ajo është lidhur në marrëdhënie besimi mes palëve, dhe për këtë shkak kontrata e shitjes së pasurisë duhet të interpretohet bazuar në qëllimin e përbashkët të palëve dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre para e pas përfundimit të kontratës, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson duke referuar në përcaktimet e neneve 681-689 të Kodit Civil lidhur me kuptimin apo sqarimin e përmbajtjes së kontratës në mënyrë që ajo të jetë e zbatueshme dhe të sjellë pasoja për palët. Bazuar në këto përcaktime ligjore, në kontratën e shitjes së pasurisë, nuk konstatohet asnjë paqartësi në kushtet apo dykuptimësi në përcaktimet e saj, që të lindë nevoja e vlerësimit të sjelljes së palëve para dhe pas lidhjes së kontratës, prandaj interpretimi i kësaj kontrate është vetëm përcaktimi i kuptimit dhe i efekteve të saj. Sipas përmbajtjes së kontratës, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka marrë në dorëzim pasurinë, dhe pala shitëse, firma “{***}” ShPK, përmes përfaqësuesit, administratorit të saj, z. M. N, ka deklaruar se ka marrë në dorëzim nga blerësi jashtë zyrës noteriale, të gjithë shumën prej 3.000.000 lekësh, shumë e deklaruar në kontratë nga përfaqësuesi i shitësit si vlerë e pasurisë. Regjistrimi i kontratës në regjistrin e ZVRPP Berat në datë 9.04.2003, provon se personi i lidhur, pala blerëse që ka fituar titullin e pronësisë, ka kryer veprimin procedural me karakter administrativ jo vetëm për efekt transparence për të bërë të ditur mënyrën e fitimit të pronësisë, por edhe për të gëzuar e disponuar qetësisht tagrat e pronarit të kësaj pasurie, përfshirë edhe mundësinë e tjetërsimit të saj.

27.6.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se: *ka nënshkruar një kontratë “tip”, pa u interesuar thellë për përmbajtjen e saj, qëllimi i së cilës lidhej me mundësinë për të realizuar marrjen e kredisë, për të cilin kishte gjetur mirëkuptimin e palës shitëse e cila do të përfitonte shumën e kredisë dhe nuk mund të penalizohet për shprehjen “e gjithë shuma prej 3.000.000 lekësh, është marrë jashtë zyrës noteriale”,* trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata është nënshkruar nga personi i lidhur, dhe jo nga vetë subjekti, dhe se për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë, specifikisht sa i përket likuidimit të çmimit të shitjes të pasurisë, si detyrimi kryesor që i buron blerësit nga kontrata dhe përfitimi për të cilin pala shitëse zhvishet nga pronësia, janë kushte thelbësore për zbatimin e kontratës dhe dorëzimin e sendit. Trupi gjykues i Kolegjit, për vetë natyrën e marrëdhënies mes palëve, të formalizuar me nënshkrimin e kontratës, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë vëmendjeje në përcaktimet kontraktuale dhe nënshkrimin e kontratës, nuk është i bazuar dhe vjen në kundërshtim me vetë përmbajtjen e kontratës, ku nga ana e noteres është deklaruar se: *Kontrata [...] iu lexua palëve me*

zë të lartë prej meje noteres, të cilët si e gjetën të njëjtë me vullnetin dhe dëshirën e tyre të lirë, nënshkruhet prej tyre pa vërejtje, para meje, noteres.

27.6.4. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrimet në Kolegj, pretendoi se deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë [datë 9.04.2003], kishin paguar te shoqëria “{***}” ShPK, shumën 2.500 USD, përkundrejt çmimit të shitjes së pasurisë prej 3.000.000 lekësh, të përcaktuar në kontratë. Bazuar në këtë deklaram, sipas pretendimit të subjektit, rezulton se në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, pala shitëse të jetë zhveshur nga pronësia pa pasur asnjë garanci të formalizuar nga pala blerëse lidhur me shlyerjen e pjesës së pashlyer të çmimit. Bazuar në deklaramin e subjektit të rivlerësimit në seancën në Kolegj, se kërkesa për përfitimin e kredisë në Alpha Bank është bërë nga bashkëshorti pas datës 15.05.2003, rezulton se, si në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë, dhe më pas, pala blerëse (bashkëshorti i subjektit) nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në bankë lidhur me paraqitjen e ndonjë kërkesë apo komunikimi në funksion të përfitimit të kredisë, për sa kohe që, me lidhjen në formë noteriale të kontratës, plotësoheshin kushtet ligjore për vlefshmërinë e saj dhe kalimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm, pra vërtetohej pronësia e sendit që do të shërbente si kolateral për kredinë³³. Duke abstraguar nga këto rrethana faktike dhe duke supozuar se pala blerëse (bashkëshorti) do të kishte paraqitur kërkesën për kredi në momentin e nënshkrimit të kontratës, pala shitëse, edhe në dijeni të një veprimi të tillë, do të mbetej e paqartë nëse pala blerëse do ta përfitonte kredinë, dhe nëse vlera e kredisë që do të miratohej nga banka do të ishte e mjaftueshme për të shlyer detyrimin [çmimin e apartamentit]³⁴. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se: *kontrata e shitjes së pasurisë është bazuar në marrëdhënie besimi mes palëve, në aspektin njerëzor si banorë të të njëjtit qytet, për të cilën pala shitëse ka mundësuar krijimin e kolateralit për palën blerëse, me qëllim përfitimin e vlerës së plotë të shitjes së apartamentit nga kredia bankare që do të përfitonte pala blerëse*, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson jobindës. Tjetërsimi i pronës pa asnjë garanci për palën shitëse për shlyerjen e detyrimit, mund të jetë premisë probabiliteti për mosshlyerjen e detyrimit nga pala blerëse, në një marrëdhënie e cila bazohet vetëm në cilësinë e bashkëqytetarëve.

- 28.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *e gjithë shuma e blerjes së kësaj pasurie prej 3.000.000 lekësh, nuk u likuidua as përpara, as në momentin e nënshkrimit të kontratës, por sipas mandateve të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në mandatet e lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, të paraqitura gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit dhe nga shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigje të kërkesës së Komisionit³⁵, emërtimi i shoqërisë, forma juridike dhe adresa e saj, nuk janë të plotësuar në rubrikat përkatëse, por pasqyrohen në vulën e shoqërisë me të cilën ato janë vulosur, e cila ka në përmbajtje edhe të dhëna për fushat e

³³ Referuar vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 01, datë 06.01.2009: “[...]Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme është i vlefshëm sepse i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663, 659 të Kodit Civil. Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me të qenit pronar mbi këtë pasuri [...]”.

³⁴ Sipas kursit të këmbimit të vitit 2003, çmimi i apartamentit prej 3.000.000 lekësh konvertohet në 22.335 euro, dhe kërkesa për kredi 20.000 euro, do të thotë pritshmëri për kredidhënie në masën 89% të vlerës së kolateralit.

³⁵ Shtatë mandatarkëtime: nr. {***}, dt. 20.03.2002, shuma 500 dollarë; nr. {***}, dt. 27.08.2002, shuma 1000 dollarë; nr. {***}, dt. 08.11.2002, shuma 1.000 dollarë; nr. {***}, dt. 01.07.2003, shuma 6610 dollarë; nr. {***}, dt. 03.07.2003, shuma 6890 dollarë; nr. {***}, dt. 04. 07.2003, shuma 4000 dollarë; nr. {***}, dt. 05.07.2003, shuma 4000 dollarë.

veprimtarisë të shoqërisë “ndërtim-eksport-import-turizëm”. Referuar historikut të shoqërisë “{***}” ShPK³⁶, nga data e themelimit deri në 02.07.2009, objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: “Punime dheu, murature, betoni, punime shembjesh, ndërtime civile, industriale etj. Punime restaurimi, të shtresave të rrugëve, ujësjellësve”; i cili në datë 02.07.2009, shtohet me “[...] 2. Aktivitete në fushën e hotelerisë”; dhe në datë 21.06.2011, shtohet me: “[...] tregti me shumicë e pakicë, import-eksport mallra industriale e bujqësore [...]”. Bazuar në këto të dhëna, në kohën e lëshimit të mandatarëtimeve, periudha 2002-2003, shoqëria “{***}” ShPK nuk kishte të regjistruar veprimtari në fushën eksport-import apo turizëm. Në kontratën e shitjes së pasurisë, si dhe në akte të tjera të kryerjes së veprimeve juridike nga shoqëria “{***}” ShPK në vitet 2002-2003³⁷, specimeni i vulës së shoqërisë paraqitet i ndryshëm nga specimeni i vulës në mandatarëtime, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje ku, për veprimtarinë e shoqërisë, rezulton e dhëna “ndërtim”. Trupi gjykues i Kolegjit, duke konsideruar se mungesa e rregullimeve ligjore në kohë lidhur me formën dhe përmbajtjen e vulës së shoqërisë tregtare, mund të përbente shkak që shoqëria “{***}” ShPK të ketë përdorur në të njëjtën periudhë kohe dy vula të ndryshme, nuk gjen relevancë për përfshirjen e veprimtarive që nuk ushtroheshin prej saj në atë periudhë dhe, sipas të dhënave zyrtare, janë regjistruar si objekt i veprimtarisë së saj vite më vonë. Gjithashtu, referuar në nenin 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”, ndër të tjera parashikohet se çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar), dhe “kërkesat e formës dhe të vlefshmërisë të dokumenteve justifikuese për t’u pranuar për regjistrime në kontabilitet, përcaktohen me regjimet kontabël”³⁸. Referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”³⁹, në pikën 2.2, “Rregullat e përgatitjes së dokumenteve justifikuese”, dokumenti justifikues bazë, mandatarëtimi, përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë të gjitha elementet e renditura në këtë pikë⁴⁰, përfshirë emrin, formën juridike dhe adresën e shoqërisë. Në mandatarëtime, pasqyrimi i emrit, formës juridike dhe adresës së shoqërisë është bërë përmes specimentit të vulës, e cila, sa u përket të dhënave të veprimtarisë së shoqërisë, nuk rezulton të jetë relevante në kohën e lëshimit të mandateve. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përmes mandatarëtimeve, të cilat nuk rezultojnë të jenë përpiluar në përputhje me rregullat e

³⁶ Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, lëshuar më datë 24.10.2011; ekstrakt i regjistrimit tregtar, lëshuar më datë 24.12.2012; ekstrakt i regjistrimit tregtar, lëshuar më datë 30.05.2013; ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, lëshuar në datë 29.01.2015.

³⁷ Në praktikën e përcjellë nga ZVRPP Berat, është pjesë edhe kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme truall, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2002, në të cilin është ndërtuar pallati ku gjendet apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit. Kjo kontratë është nënshkruar nga administratori, z. M. N, që ka përfaqësuar shoqërinë “{***}” ShPK, dhe është vulosur me vulën e shoqërisë.

³⁸ Plani i Përgjithshëm Kontabël, faqe 12, miratuar me VKM-në nr. 334, datë 09.07.1993, bazuar në ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993 (Fletore Zyrtare nr. 11).

³⁹ Referuar nenit 2 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, regjimet kontabël miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe bazuar në nenin 3, pika “a” e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton sistemin kontabël të përgjithshëm.

⁴⁰ Në pikën 2.2, përcaktohet se: “dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë: a) emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial) si dhe datën; b) emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes; c) tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare; ç) përshkrimin e përmbajtjes së objektit të veprimit apo të ngjarjes tjetër dhe, në varësi të natyrës së këtyre të fundit, treguesit sasiore dhe vlerorë; d) veprimet për shitjen e sendeve, furniturat, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen në çdo rast me faturë”.

kohës, nuk mund të provohet koha e kryerjes së pagesave për blerjen e pasurisë, për rrjedhojë pretendimi i subjektit është i pabazuar në ligj e prova.

28.1. Në seancën gjyqësore në Kolegj, lidhur me arsyen e copëzimit të shlyerjes së detyrimit pas disbursimit të kredisë më datë 02.07.2003, duke referuar vlerat përkatëse të mandatarkëtimeve të datave 3, 4 dhe 5 korrik 2003, i cili sillte vonesa të tjera në kohë për arkëtimin e detyrimit nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kjo ka ndodhur për të përfituar nga kursi i këmbimit. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen jobindës këtë shpjegim të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, përkundrejt parashtrimeve të saj në ankim për mirëkuptim nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK për shlyerje të plotë të çmimit të apartamentit me kredinë e përfituar nga Alpha Bank, pa pretenduar se ky mirëkuptim nga ana e shoqërisë shtrihej edhe pas disbursimit të kredisë në funksion të përfitimeve të mundshme të subjektit nga kursi i këmbimit të monedhës euro me dollarë.

28.2. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në seancën në Kolegj, pretendoi se: *nënshkrimi i administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, në mandatin bankar të disbursimit të plotë të kredisë [emër, mbiemër, nënshkrim], provon se banka ka qenë në dijeni se kredia do të shkonte për shlyerjen e apartamentit, dhe se vetë banka ka qenë e interesuar që shumica e kredisë të shkonte në destinacionin për të cilin ajo ishte dhënë.* Subjekti në ankim, megjithëse bashkëlidhur tij kishte paraqitur këtë mandat të bankës, nuk kishte ngritur pretendime lidhur me provueshmërinë e tij përkundrejt marrëdhënies së mirëkuptimit me shoqërinë “{***}” ShPK, apo të interesit të bankës përkundrejt kësaj shoqërie, ndërsa në parashtrimet e paraqitura në seancë pretendoi se ky fakt ishte vënë re prej saj gjatë përgatitjes përpara zhvillimit të seancës në Kolegj. Në kontekst të qartësimit lidhur me këto pretendime të paraqitura rishtazi, subjektit të rivlerësimit në seancë iu kërkua të sqarojë se cili ishte veprimi juridik (kontrata) që Alpha Bank kishte financuar në kuadër të aplikimit për kredi me qëllim “blerje apartamenti”. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar për pamundësi për të kujtuar saktësisht veprimet për shkak të kohës së largët, pohoi se me aplikimin për kredi ndoshta është paraqitur kontrata e shitblerjes së apartamentit e datës 09.04.2003, por paraqitja e certifikatës së pronësisë ishte kushti që banka të jepte kredinë. Ky pohim i subjektit dëshmon sërish se banka ka shqyrtuar aplikimin për kredi të subjektit duke administruar dokumentacion ligjor provues që subjekti gëzonte tagra të plota të pronësisë së apartamentit në Berat, për rrjedhojë nuk kishte nevojë objektive që nga ana e bankës të verifikohej e në vijim të miratohej dhënia e kredisë për blerjen e këtij apartamenti. Trupi gjykues i Kolegjit, duke konstatuar edhe në këtë rast ndryshime të qëndrimit të subjektit në formën e shpjegimeve jobindëse, vlerëson se mandati bankar, si dokument provues për palën kreditore, bankën, ka vlerë dokumentuese për të provuar përmbushjen e detyrimit të lëvrimit të gjithë shumës së kredisë ndaj kredimarrësit. Në këtë kontekst, banka nuk do të kishte arsye të lejonte e aq më pak të kërkonte nënshkrimin e mandatis nga shtetasi M. N, i cili nuk gëzonte asnjë cilësi në raport me bankën në marrëdhënien e kredisë. E pyetur në seancë për të dhënë shpjegime për arsye të mundshme të Bankës për përfshirjen e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK si nënshkrues të mandatis të disbursimit të kredisë, për sa të drejtat dhe detyrimet lidhur me kredinë shtrihen vetëm mbi kredimarrësit, në këtë rast subjektit dhe bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, me përgjigjen e saj: *e ka marrë vetë banka, janë politikat e bankës, nuk di si të shprehem [...]*, nuk arriti të japë shpjegime bindëse. Për më tepër, ky mandatarkëtim nuk përfshihet në praktikën e kredisë të përcjellë në Kolegj nga Alpha Bank, por është pjesë e dokumenteve që subjekti paraqiti në seancë, si praktika e kredisë përcjellë nga Alpha Bank në përgjigje të kërkesës së saj. Në analizë të këtij dokumentacioni të paraqitur nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se shkresës

përcjellëse i mungonte numri i protokollit, element garantues për provueshmërinë e përcjelljes së dokumentacionit në rrugë zyrtare, po ashtu mungonin emër, mbiemër për nënshkrimet e pasqyruara në fund të saj. Trupi gjykues i Kolegjit, duke konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti shfaqte të meta të cilat cenonin vlerën provuese të tij në këtë proces dhe duke çmuar se dokumentacioni i përcjellë nga Alpha Bank në Kolegj, nën përgjegjësinë që i buron këtij institucioni nga përcaktimet e ligjit nr. 84/2016⁴¹, vlerëson se pretendimi i subjektit është i papabazuar në ligj e prova dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

29. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit *për deklarim të pamjaftueshëm për shkak të mospërputhjeve të rezultuara midis deklarimit të subjektit në deklaratën “vetting” se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në shumën 20.000 euro dhe pagesave të kryera përpara disbursimit të saj në shumën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe, pas disbursimit të kredisë në shumën 14.890 USD, ose rreth 13.000 euro*, me pretendimin se data e mandatar-këtimit nr. {***} është plotësuar gabim nga nëpunësi i shoqërisë, dhe vlera 6.610 USD e pasqyruar në këtë mandat është shlyer pas disbursimit të kredisë.

29.1. Subjekti i rivlerësimit, duke i qëndruar pretendimit se pagesat për shlyerjen e vlerës së apartamentit janë kryer pas disbursimit të kredisë më datë 2.07.2003, lidhur me datën 1.07.2003 të mandatar-këtimit nr. {***}, ku pasqyrohet vlera 6610 dollarë, fillimisht ka dhënë shpjegime se mandati ka të bëjë me kontabilitetin e shoqërisë, ndërsa, pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar për gabim rutinë nga ana e përpiluesit të dokumentit në plotësimin e datës së mandatit, pa u vënë re prej tyre. Në seancën publike në Kolegj, për mandatin nr. {***}, subjekti i rivlerësimit pretendoi se plotësimi i datës 01.07.2003 është lapsus i përpiluesit. Shoqëria “{***}” ShPK, edhe pse ka dërguar informacion zyrtar në Komision se të gjitha vlerat janë paguar pranë arkës së firmës sipas mandatar-këtimeve, duke referuar në shkresë numrin, datën dhe vlerën përkatëse, si dhe duke dërguar bashkëlidhur kopje të tyre, përmes deklaratave noteriale të administratorit dhe ortakut të shoqërisë të paraqitura nga subjekti bashkë me ankimin, kërkon të paraqesë një situatë të ndryshme për arkëtimin e shumës 6610 dollarë, duke kërkuar të informojë se data 1.07.2003 në mandatin nr. {***}, është gabim njerëzor nga ana e nëpunësve të shoqërisë dhe se kjo shumë është arkëtuar në datë 2.07.2003. Trupi gjykues i Kolegjit, duke abstraguuar nga situata faktike kur marrëdhënia juridiko-civile e shitblerjes së pasurisë “apartament”, e rregulluar mes palëve me kontratën e lidhur rregullisht përpara noterit, dhe çmimi i blerjes së apartamentit është shlyer paraprakisht nga blerësi, vlerëson se mungesa e konsistencës në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, lidhur me dokumentacionin përmes të cilit synon të provojë pretendimet e saj, sikundër edhe gatishmëria e përfaqësuesve të shoqërisë “{***}” ShPK, për të deklaruar në Kolegj të dhëna të ndryshme nga informacioni shkresor dhe dokumentet e dërguara prej tyre në Komision, i bën jobindëse pretendimet e subjektit për datën e shlyerjes prej saj të shumës 6610 dollarë.

30. Lidhur me pretendimin e subjektit se edhe në të kundërt, Komisioni ka konstatuar se unë kisha aftësi paguese, pasi kisha një vlerë prej 1.500.000 lekësh gjendje, prandaj bie varianti i balancës negative, pasi 9910 dollarë konvertohen në 1.139.000 lekë me kursin e kohës, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1998 - mars 2003, subjekti rezulton me mjaftueshmëri financiare në vlerën 1.454.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit, pavarësisht se nga

⁴¹ Ligji nr. 84/2016, në nenin 50, pika 4, përcakton se: “Me kërkesë të Komisionit ose Kolegjit të Apelit, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera që ushtrojnë aktivitete bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të japin informacion mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur më të”.

analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 01.01.1997 - 31.03.2003⁴², rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, ka mjaftueshmëri të burimeve financiare në shumën 1.684.899 lekë, vlerëson se deklaratimet e saj në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, ku në të dyja rastet si burim për krijimin e pasurisë ka deklaruar të ardhurat nga paga në shumën 300.000 lekë dhe kredinë në Alpha Bank, përjashtojnë përfshirjen e burimeve të tjera financiare për blerjen e kësaj pasurie.

31. *Për pasurinë automjet, tip “Ford Fiesta”, me targa {***}, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesë financiare në shumën 421.341 lekë për blerjen e kësaj pasurie dhe për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për krijimin e saj, me pretendimin se këto konkluzione vijnë për shkak: 1) të interpretimit të gabuar të dokumentacionit të administruar në praktikën e kredisë së përfituar nga subjekti në vitin 2009, në ish-Bankën Popullore (Societe Generale Albania), sot OTP Bank, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 ka shpenzuar 436.365 lekë; 2) të përllogaritjes së gabuar të shpenzimeve për shkollimin e vajzës; 3) të përfshirjes së shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit në Turqi, të cilat sipas saj janë mbuluar nga organizatorët e aktivitetit. Gjithashtu, në mënyrë të ndërlidhur me këtë shkak ankimor, subjekti i rivlerësimit, bazuar në të njëjtin pretendim për interpretim të gabuar të dokumentacionit të administruar në praktikën e kredisë së përfituar nga subjekti në vitin 2009, në ish-Bankën Popullore (Societe Generale Albania), sot OTP Bank, kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për arredimin e pasurisë, apartament në qytetin e Beratit. Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:*

31.1. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka pasur mungesë financiare në vlerën 429.341 lekë për blerjen në vitin 2006 të pasurisë automjet [tip “Ford Fiesta”], për shkak të balancës negative të këtij viti, ardhur si rezultat i përfshirjes në analizën financiare të këtij viti të shumës të prej 436.356 lekësh, në zërin “arredim i apartamentit në Berat”. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i praktikës bankare të kredisë së marrë nga subjekti në ish-Bankën Popullore në vitin 2009, ka konstatuar se në pasqyrën e orendive të apartamentit në qytetin e Beratit, ku evidentoheshin thujtë të njëjtat orendi me ato të deklaruara nga subjekti në pyetësorë, shuma e arredimit pasqyrohej në vlerën 2.030.000 lekë, ose 6,23 herë më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti. Bazuar në informacionin e Bankës OTP, se shuma e pasqyruar për blerjen e orendive mund të jetë reflektuar ose nëpërmjet intervistimit të bërë me përfituesin e kredisë [bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe subjekti], ose është cilësuar sipas çmimeve të tregut nga punonjësi i bankës, Komisioni ka analizuar se: i) nëse subjekti është intervistuar, orenditë janë po të njëjta dhe vlera është pranuar nga i intervistuari e, për pasojë, shuma është vetëm përllogaritje totale, duke nënkuptuar në këtë rast dijeni të plotë të subjektit për shumën, në kundërshtim me pretendimin e saj mbi një tjetër shumë; ii) nëse subjekti nuk është intervistuar, sikundër pretendon, atëherë qëndron varianti tjetër se vlerësimi i orendive është bërë nga një punonjës i bankës, sipas çmimeve të tregut, i cili jo vetëm konfirmon vlerën 2.030.000 lekë, por reflekton edhe faktin se sa kanë qenë vlerat e orendive në atë vit, që për nga përllogaritjet kohore nuk duket të kenë qenë të largëta me vitet e pretenduara nga subjekti për kryerjen e arredimit [2002-2006], çka përforcon provueshmërinë e shumës; iii) cilësimi i orendive duket të jetë i pamundur të ideohet dhe përcaktohet nga një punonjës banke, në raport me zotëruesin e vërtetë të orendive, që në këtë rast

⁴² Në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 1997, u përfshinë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga pagat, sipas të dhënave të dokumentacionit të administruar në fashikujt e Komisionit, si dhe për këtë vit u llogaritën shpenzimet e jetesës në vlerën 60% të të ardhurave.

janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj; iv) banka në përgjigjen e saj nuk përjashton apo nuk vë në dyshim vlerën e orendive, por e rikonfirmon atë në të dyja alternativat e mundshme për aplikim nga ana e saj. Nën këtë arsyetim dhe për sa subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nuk paraqiti dokument justifikues për të provuar vlerën reale të shpenzimit të arredimit të apartamentit sipas pretendimit të saj, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumën 2.030.000 lekë, duke e shpërndarë atë në periudhën 2002-2006, sipas deklaramit të subjektit për kryerjen e arredimit. Për vitet 2005 dhe 2006, shumat e zërit “shpenzime për arredim”, kanë ndikuar në bilancin negativ të analizës financiare të këtyre viteve.

31.2. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ashtu dhe në ankimin e parashtrimet e tij përpara Kolegjit, pretendon se shuma e shpenzuar për arredimin e apartamentit në qytetin e Beratit përgjatë periudhës 2002-2006, është 321.000 lekë⁴³. Lidhur me praktikën e kredisë bankare të marrë në vitin 2009 në ish-Bankën Popullore, sa u përket shkresave ku pasqyrohet vlera e arredimit të apartamentit në Berat, subjekti i rivlerësimit pretendon se: i) përmbajtja e dokumenteve të brendshme të bankës ka autor nëpunësit e saj, kredimarrësit në asnjë rast nuk përgatisin raporte bankare; ii) subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti) nuk janë pyetur ose intervistuar, në praktikën bankare nuk deklarohet të jetë kryer intervistim i tyre, të jetë ofruar ndonjë dokument burimor nga ana e tyre ose të jetë kryer ndonjë verifikim nga specialistët e bankës për gjendjen reale të pajisjeve shtëpiake; iii) me analizën dhe pasqyrat bankare është njohur vetëm në momentin që ka marrë dokumentacionin e hetimit administrativ nga KPK-ja; iv) shkresat “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve” dhe “Komente mbi pasqyrat financiare”, nuk kanë vlerën e provës pasi nuk janë të nënshkruara nga punonjësit e bankës. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me arredimin e apartamentit në qytetin e Beratit, ka kërkuar këqyrjen nga Komisioni të këtij arredimi, kërkesë e cila është refuzuar me vendim nga Komisioni, duke arsyetuar se vlerësimi *i orendive shtëpiake nuk do të ishte objektiv, për sa kohë arredimi është kryer thuasje 13 vjet përpara sipas deklaramit të vetë subjektit.*

31.3. Trupi gjykues i Kolegjit, në referim të faktit se kuadri ligjor që ka rregulluar kontrollin dhe deklaramin e pasurive të subjekteve që mbartin detyrim për deklaram të pasurive, deri në vitin 2012 nuk përcaktonte detyrim për deklaram të shpenzimeve nën 500.000 lekë, përfshirë edhe ato të arredimit, analizoi fillimisht deklaramet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji *se saktësia dhe konsistenca e deklarameve për këtë lloj shpenzimi mbetet e rëndësishme dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit*⁴⁴. Nga dokumentacioni në fashikujt e Komisionit, përkundrejt pretendimeve të subjektit, analizohet si vijon:

31.3.1. Komisioni, pas verifikimit të praktikës së kredisë në ish-Bankën Popullore në vitin 2009⁴⁵, ku vlera e arredimit të apartamentit ka rezultuar 6,32 herë më e lartë se sa ajo e deklaruar nga subjekti, ka pyetur subjektin për këtë mospërputhje. Në adresimin e pyetjes, Komisioni ka renditur pajisjet dhe vlerat përkatëse sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, duke informuar

⁴³ Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se arredimi i apartamentit në qytetin e Beratit është kryer përgjatë viteve 2002 deri në 2006, në vlerën 321.000 lekë, si dhe ka listuar orenditë dhe vlerat e tyre. Në përgjigje të pyetësorit {***} të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet për këtë arredim, duke specifikuar shumat e shpenzuara në secilin vit: viti 2002: 99.000 lekë (orendi të blera gjatë viteve 1997-2002); viti 2003: 58.000 lekë; viti 2004: 60.000 lekë; viti 2005: 35.000 lekë; viti 2006: 69.000 lekë.

⁴⁴ Shih vendimin e Kolegjit nr. 25, datë 29.07.2021.

⁴⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 29.07.2009 (f. 4, f. 368).

se sipas akteve të dosjes së kredisë të ish-Bankës Popullore të vitit 2009, pajisjet e arredimit të apartamentit janë në vlerën 2.030.000 lekë. Përgjigjja e subjektit për këtë pyetje, se kredia në ish-Bankën Popullore Berat është marrë për blerje shtëpie, sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 3 të kontratës së kredisë, pasi më datë 02.03.2009, bashkëshorti është transferuar me punë në Tiranë, nuk ka relevancë me qëllimin e pyetjes. Përkundrejt pyetjes së qartë, përgjigjja e subjektit, në shmangie të dhënies së shpjegimeve, bën që pretendimet e ngritura në ankim, se nuk janë pyetur apo intervistuar nga punonjësit e bankës lidhur me to, mbetet i paargumentuar bindshëm. Duke analizuar *a contrario*, në qoftë se ky pretendim do të ishte i bazuar, subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nuk do të kishte arsye për të mos deklaruar se nuk mund të japë shpjegime lidhur me mospërputhjen e vlerave të deklaruara prej saj me vlerat e praktikës së kredisë bankare, pasi nuk është pyetur apo intervistuar nga punonjësit e bankës lidhur me pajisjet e arredimit dhe nuk ka qenë në dijeni të kryerjes nga ana e bankës së një vlerësimi për to.

31.3.2. Subjekti ka marrë dijeni për të dhënat e arredimit të rezultuara nga aktet e praktikës së kredisë së ish-Bankës Popullore përmes pyetësorit të datës 18.07.2019, përpara se të njihej me rezultatet e hetimit administrativ më datë 12.11.2019, me të cilin Komisioni i ka kaluar barrën e provës për vlerën e arredimit të apartamentit në Berat. Subjekti ka synuar ta përmbushë barrën e provës përmes kërkesës së datës 14.11.2019, për këqyrje në vend nga ana e Komisionit të arredimit të apartamentit. Gjithashtu, më datë 14.11.2019, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i është drejtuar Bankës OTP, Dega Berat, duke kërkuar: [...] *nisur nga paqartësi të krijuara gjatë komunikimit shkresor me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kërkojmë nga ana juaj të jepni shpjegime sa më poshtë: në dokumentacionin e kredisë rezulton një praktikë ku subjekti ka deklaruar arredimin e shtëpisë, shumë e pasqyruar në tabelë. 1) Kërkojmë të njihemi me këtë praktikë. 2. Kërkojmë nga ana juaj të shpjegoni si realizohen këto praktika dhe për çfarë arsye përdoren [...].* Ndërsa më datë 18.11.2019, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i është drejtuar me kërkesë Bankës OTP, zyra qendrore, Tiranë, ku fillimisht ka listuar shtatë dokumente të praktikës së kredisë⁴⁶, për të cilat ka sqaruar se janë pjesë e dosjes së kredisë që banka ka përcjellë në Komision dhe ka kërkuar nga banka shpjegime për: [...] *1. këto dokumente përpilohen nga specialistët e bankës apo nga kredimarrësit; 2. a njihen kredimarrësit me këto dokumente; 3. na përcillni dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë për këtë kredi [...] në datë 14.11.2019, kemi dorëzuar kërkesë në OTP, Dega Berat me nr. {***} prot., dhe nuk kemi marrë përgjigje [...].* Për efekt të datës së caktuar për paraqitjen e pretendimeve për rezultatet e hetimit kryesisht, më datë 21.11.2019, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, i është ridrejtuar Bankës OTP duke referuar të dyja kërkesat e paraqitura, të mbetura pa përgjigje, dhe duke kërkuar kthimin e përgjigjes brenda të njëjtës datë për shkak të mbarimit të afatit. Banka OTP, në po të njëjtën datë, përmes *e-mail*-it, ka informuar se po punojnë për kthimin e përgjigjes, duke theksuar se: [...] *ju lutemi të konsideroni që në procedurat e bankës, afati standard për kthimin e përgjigjeve është 10 ditë pune. [...].* Në procesin e rivlerësimit, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit⁴⁷, përpos detyrimit ligjor në funksion të qartësisimit të situatave faktike, është edhe në interes të vetë subjektit për provueshmërinë e deklarimeve të tij. Në këtë kontekst, paraqitja e kërkesave në OTP Bank, lidhur me shpjegime apo dokumentacion nga praktika e kredisë, dy muaj pas marrjes dijeni

⁴⁶ Në kërkesë janë listuar: 1. Analizë e kredive konsumatore; 2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; 3. Komente mbi njësinë social-ekonomike; 4. Analizë e kredive konsumatore; 5. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; 6. Komente mbi pasqyrat financiare; 7. Plani i investimit.

⁴⁷ Neni 48 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysht gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit".

lidhur me të dhënat e rezultuara për vlerën e arredimit nga ky dokumentacion, dhe vetëm disa ditë përpara afatit të paraqitjes së pretendimeve për rezultatet e hetimit, dëshmon më së paku për neglizhencë të subjektit, ose për mungesë pritshmërie lidhur me provueshmërinë e pretendimeve përmes përgjigjes së Bankës OTP.

31.3.3. OTP Bank, në përgjigje të kërkesave të subjektit referuar në pikën 31.3.2, po më datë 21.11.2019 ka kthyer përgjigje⁴⁸: [...] *ju keni kërkuar nga banka informacion mbi praktikën e analizave për efekt të kredidhënies (konkretisht për dokumentacionin e listuar në shkresën tuaj dt. 18.11.2019, i cili i është vënë në dispozicion KPK-së nga ana e bankës) [...] dokumenti të cilit ju i referoheni në kërkesën tuaj, i përket një modeli të hedhjes së të dhënave prej punonjësit të bankës gjatë analizës së kredive. Në vijim të kërkesës për informacion për përdorimin e këtij dokumenti nga banka, ju sqarojmë se ky dokument ka qenë vetëm për përdorim të brendshëm të bankës dhe përdorej si pjesë e propozimit të kredisë për klientët individë që kanë të ardhura nga pagat [...] dokumenti i sipërpërmendur përmban edhe një përmbledhje të asetëve që zotëron aplikuesi për kredi, duke përfshirë pronat, automjetet, pajisjet shtëpiake etj. Pra, në kuadër të vlerësimit në total të situatës së aplikantit për kredi, bëhet nga analisti përgjegjës edhe një përshkrim i asetëve që zotëron aplikanti [...] duke qenë se kanë kaluar mbi 10 vite nga disbursimi i kredisë, si dhe nisur nga fakti se analisti i kredisë dhe drejtori i degës që kanë përgatitur dosjen në vitin 2009, nuk janë më pjesë e institucionit tonë, e kemi të vështirë të konfirmojmë të saktë mënyrën si është marrë dhe vendosur ky informacion, nisur edhe nga fakti që standardet, procedurat dhe metodologjia e vlerësimit të aplikimeve për kredi ka pasur ndryshime të vazhdueshme. Gjithsesi, mund të konfirmojmë se pjesë standarde e praktikës së aplikimeve për kredi, ka qenë intervista me klientin, me anë të së cilës grumbullohet informacioni verbal dhe në varësi të rastit, mund të kërkohet dokumentacion justifikues për asetet që aplikuesi disponon.*

Në rastin tuaj, nuk mund të konfirmojmë nëse vlerat e pajisjeve shtëpiake janë marrë prej deklaramit tuaj verbal apo nëse analisti përkatës i ka vendosur bazuar në referencat e tregut për pajisje të ngjashme. Mund të komentojmë që nga këndvështrimi i bankës, të dyja mënyrat kanë qenë të aplikueshme, për sa kohë ato shërbenin për vlerësimin e situatës ekonomike të klientit. Në dosjen e kredisë nuk disponojmë të firmosur prej jush ndonjë deklaramit të vlerës së këtyre pajisjeve shtëpiake apo ndonjë dokument shoqërues (preventiv) për koston e blerjes së tyre dhe, nisur nga fakti që janë vendosur vlera fikse (të rrumbullakosura), ekziston mundësia që analisti i kredisë t'u jetë referuar vlerave të përafërta të tregut [...]. Trupi gjykues i Kolegjit, nga përgjigjja e bankës, konstaton se:

31.3.3.1. Sipas informacionit të Bankës OTP, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për kredi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në vitin 2009, vlerat e pajisjeve shtëpiake janë vendosur nga analisti i kredisë, në zbatim të procedurës së bankës si për çdo kredi për klientë individë. Bazuar në këtë informacion, pretendimi i subjektit se *nëpunësit e bankës nuk janë as ekspertë, dhe nëse ata i kanë përpiluar këto dokumente mund të jenë ngatërruar me të tjerë persona, vlerësohet i pabazuar.*

31.3.3.2. Bazuar në faktin se në pasqyrat financiare të bankës, pajisjet e arredimit të shtëpisë janë pothuaj të njëjta me ato të deklaruara nga subjekti, si dhe në informacionin e bankës *se pjesë standarde e praktikës së aplikimeve për kredi, ka qenë intervista me klientin, me anë të së cilës grumbullohet informacioni verbal, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, se*

⁴⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 21.11.2019, me lëndë "Kthim përgjigje ndaj shkresës tuaj me datë 18.11.2019, nr. {***} prot., dhe shkresës datë 14.11.2019, nr. {***} prot."

ajo dhe bashkëshorti nuk janë pyetur apo intervistuar nga punonjësit e bankës lidhur me pajisjet e arredimit, mbetet jobindës. Aplikimi i metodologjisë tjetër të bankës për vendosje të vlerave nga analisti i kredisë, *bazuar në referencat e tregut për pajisje të ngjashme*, nuk duket të jetë aplikuar në rastin e subjektit, ku në dokument janë listuar 2 TV, me vlera të ndryshme, të dhëna të cilat në mungesë të informacionit nga kredimarrësi, nëpunësi i bankës jo vetëm që nuk do të ishte në dijeni sa aparate TV disponoheshin prej tij, e aq më pak të çmimit të ndryshëm të tyre.

31.3.3.3. Lidhur me pretendimin e subjektit, për mundësinë e përfshirjes nga analisti i bankës të çmimeve të tregut, se *çmimet e tregut variojnë nga 5 lekë deri në shuma marramendëse që nuk hyjnë në llojin tim*, trupi gjykues i Kolegjit analizon, *së pari*, se banka në shkresën e saj nuk ka pohuar se në rastin kur vlerësimi bazohet në çmimet e tregut, ato referohen në vlerën më të lartë; *së dyti*, vlera e arredimit nuk ka qenë pjesë e kolateralit, për pasojë nuk ndikonte e aq më pak të kushtëzonte përfitimin e kredisë, prandaj nuk ka arsye, qoftë edhe subjektive, për rritjen e vlerës së orendive duke referuar çmimet më të larta të tregut.

31.3.3.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se, për sa në shkresën e bankës ka elemente të pavlefshmërisë të verifikuara nga Komisioni, atëherë akti/shkresa e cila gjithashtu nuk është firmosur nga nëpunësit e bankës, nuk mund të ketë vlerën e provës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se hetimi i kryer nga Komisioni për kredinë 7000 euro, të pasqyruar në këtë dokument, ku ka rezultuar se kjo shumë është në vijim të kredisë nr. {***}, datë 27.06.2003, provon se nuk ka elemente të pavërteta, për sa detyrimi (shuma e kredisë) dhe shlyerja e saj, rezultojnë të provuara. Pretendimet e tjera të subjektit për pasaktësi të shifrave të tjera të referuara në dokumentin e bankës: 1) sa i përket çmimit të “makinës”, në dosjen e kredisë nuk rezulton të jetë administruar ndonjë dokument për të vërtetuar/referuar çmimin e blerjes apo dhe vetë llojin e makinës, duke përforcuar idenë që të dhënat për posedimin e këtij asemi dhe vlerën e tij të kenë burim deklaratimet e klientit në momentin e intervistimit; 2) sa i përket pasqyrimin të shumës 500.000 lekë, si investime të bëra në apartament dy vite më parë, gjithashtu janë të dhëna të pamundura të sigurohen përpos me intervistën me klientin; 3) sa i përket pretendimit se *për të njëjtën gjë ka dy vlera*, konstatohet se subjekti u referohet dy formateve “Analizë e kredive konsumatore” të administruara në dosjen e kredisë bankare. Njëri prej formateve, i plotësuar me shkrim dore në disa rubrika, mban datën 10.07.2009, në po të njëjtën datë që bashkëshorti i subjektit ka paraqitur të nënshkruar kërkesën për kredi. Në formatin tjetër, plotësuar me kompjuter, në të gjitha rubrikat e tij, i cili mban datën 15.07.2009, në rubrikat korresponduese me formatin e parë, shifrat janë të ndryshme. Kronologjia e datave, mënyra e plotësimit, si dhe plotësia e të dhënave, dëshmojnë se nga momenti i aplikimit të kredimarrësit dhe të dhënave të referuara po atë ditë, kryerja e analizës ka marrë kohën e saj në funksion të sigurimit dhe saktësisht të të dhënave të kërkuara. Bazuar në këtë analizë, si dhe në referim të informacionit të Bankës OTP që, *në kuadër të vlerësimit në total të situatës së aplikantit për kredi, bëhet nga analisti përgjegjës edhe një përshkrim i aseteve që zotëron aplikanti*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për këto dokumente, të krijuara sipas procedurave të bankës, nën përgjegjësinë e nëpunësve të bankës dhe në funksion të garantimit të bankës për dhënien e kredisë, pretendimet e subjektit për pavërtetësi apo pasaktësi domethënëse të tyre janë të tejkaluara. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe pse dokumentacioni i dosjes së kredisë vjen në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi është siguruar nga një burim i besueshëm, banka, e cila gjithashtu e rikonfirmon atë,

bazuar në nenin 246 e vijues të Kodit të Procedurës Civile⁴⁹, shkresa e bankës nuk ka fuqi provuese sepse nuk rezultojnë të përmbajë elemente themelore të formës, siç është nënshkrimi i nëpunësit/ve që e ka/në përpiluar atë.

31.4. Trupi gjykues i Kolegjit, duke marrë në konsideratë pretendimin e subjektit *se për periudhën e largët, nuk mund të ruaja dokumente provuese të çmimeve referente të orendive shtëpiake, të faturave, të mandatpagesave apo provave të tjera të tërthorta*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nuk ishte e besueshme në vlerën e përcjellë prej saj si shpenzime të arredimit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Vlera prej 320.000 lekësh, e ndarë si shpenzim i kryer në katër vite, përbën një vlerë jorealiste për kryerjen e shpenzimeve për të bërë të banueshme një banesë në momentin e fillimit të banimit në të, ndërkohë që dhe përlllogaritja e kryer nga analisti i kredisë nuk provohet që të ketë përfshirë vlera si rezultat i intervistës me klientin, sikundër dhe akti i bankës ku janë pasqyruar vlerat e arredimit, i pafirmosur prej tij, formalisht nuk përbën provë. Gjendur në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit ishte në kushtet e pamundësisë për përlllogaritjen e një vlere të saktë të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet, i tipit “Ford Fiesta”, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare për vitin 2006. Nëse shpenzimi për arredim do të përlllogaritej sipas vlerës së përcaktuar në dokumentet e kredisë bankare, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit dhe për përballimin e shpenzimeve familjare do të ishte në vlerën 420.185 lekë. Pavarësisht pamundësisë për përlllogaritje të saktë të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për vitin 2006, bazuar në analizën financiare të kryer në Kolegji, sipas versionit të vlerës së shpenzimeve të arredimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, përsëri subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të përballuar shpenzimet familjare dhe për të blerë pasurinë automjet, i tipit “Ford Fiesta”, në një vlerë 52.829 lekë.

31.5. Lidhur me pretendimin e subjektit për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve për shkollimin e vajzës, pasi në përlllogaritje Komisioni ka përfshirë 10 muaj, dhe jo 9 muaj, sa është kohëzgjatja e vitit shkollor në ciklin 8-vjecar, trupi gjykues i Kolegjit, duke marrë në konsideratë *së pari* fillimin dhe mbarimi i çdo viti shkollor, kohëzgjatjen e tij, pushimet, sikundër edhe ndërprerjet që për shkaqe objektive, përcaktohen me urdhër të Ministrisë të Arsimit; *së dyti*, një vit kalendarik nuk përfshin kohëzgjatjen e një viti të plotë shkollor (*përfshin muajt përmbyllës të vitit shkollor që ka filluar një vit më përpara dhe muajt e parë të vitit shkollor që do të përmbillet një vit më pas*), dhe për këto arsye nuk mund të pretendohet që në një vit kalendarik, periudha gjatë së cilës zhvillohet mësim, të përkojë me kohëzgjatjen e vitit shkollor; *së treti*, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se gjatë vitit 2006, për ciklin 8-vjeçar, periudha mësimore ka përkuar me 9 muaj; *së katërti*, edhe duke përlllogaritur shpenzimet e shkollimit të vajzës për 9 muaj (*nga 10 muaj të përlllogaritur nga Komisioni*), balanca negative e vitit 2006 nuk ndryshon, për sa ndryshimi do të konsistonte në diferencën me 4000 lekë, sa është tarifa mujore e deklaruar nga shkolla jopublike. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar në ligj e prova.

31.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se udhëtimi i bashkëshortit në Turqi në vitin 2006, është kryer në kuadër të një vizite pune dhe shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët, dhe, për pasojë, Komisioni ka gabuar në përfshirjen e këtyre shpenzimeve, dhe po ashtu në

⁴⁹ Neni 246 i Kodit të Procedurës Civile, i titulluar “Fuqia provuese e shkresave”, parashikon se: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

përlllogaritjen e tyre në 4 nga 3 net qëndrimi, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i dokumentacionit, vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit lidhur me kohëzgjatjen 3 net të qëndrimit të bashkëshortit në Turqi, ndërsa pretendimin se shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët e vlerëson të pabazuar, në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur prova për të mbështetur këtë pretendim, nuk shprehet në ankim dhe as provon të këtë kërkuar nga ana e organizatorëve një vërtetim lidhur me mbulimin nga ana e tyre të shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit në Turqi, e në vijim për mospërgjigje apo përgjigje negative nga ana e tyre, të parashtrijë se është në pamundësi objektive për të disponuar dhe paraqitur një dokument lidhur me sa pretendon, por mjaftohet me pohimin se *në atë kohë ndoshta veprohej me e-mail-e dhe telefonata*. Për rrjedhojë, në analizën financiare të kryer në Kolegj, u përfshi vlera e shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit të subjektit për 3 net, ndryshim i cili nuk ndikon në pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit për vitin 2006.

32. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për konkluzionin e Komisionit mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 314.272 lekë për të përballuar shpenzimet e jetesës në vitin 2005, për të cilin subjekti shprehet se vjen për shkak: 1) të interpretimit të gabuar të dokumentacionit të administruar në praktikën e kredisë të përfituar nga subjekti në vitin 2009, në ish-Bankën Popullore; 2) të mospërfshirjes së depozitave të krijuara në vitin 2004 (1000 USD dhe 2000 euro), të cilat janë përdorur për shlyerjen pjesore të kredisë në vitin 2005, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

32.1. Për sa analizuar dhe vlerësuar në pikën 27.4, duke qenë se viti 2005 përfshihet në periudhën 2002 - 2006 të kryerjes së shpenzimeve për arredimin e apartamentit në Berat, nuk mund të kryhet përlllogaritja e saktë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit për kryerjen e shpenzimeve familjare. Megjithatë, bazuar në analizën financiare të kryer në Kolegj sipas versionit të vlerës së shpenzimeve të arredimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, subjekti në vitin 2005 gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet familjare në një vlerë prej 127.932 lekësh. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

32.2. Në lidhje me pretendimin e subjektit për mospërfshirje për likuidim pjesor të kredisë në vitin 2005, të depozitave të krijuara në vitin 2004 (1000 USD dhe 2000 euro), nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se për vitin 2004 është pasqyruar gjendje likuiditeti në bankë, me vlerë 281.461 lekë, pa referuar lidhur me përbërjen e kësaj vlere. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, në analizën e saj financiare të paraqitur në ankim, vlerën e dy depozitave, të konvertuar në 370.000 lekë, ia ka shtuar gjendjes së pasqyruar nga Komisioni, duke e sjellë gjendjen e likuiditeteve në vitin 2004, në vlerën 651.461 lekë. Në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2005, u përfshi vlera e dy depozitave bankare të vitit 2004, përkatësisht 1000 USD dhe 2000 euro, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, si dhe të konfirmuar nga institucionet ndihmëse në procesin e rivlerësimit, e cila, konvertuar me kursin e këmbimit të kohës, rezulton 384.377 lekë. Pavarësisht saktësisht të shifrës së gjendjes së likuiditeteve, balanca negative për vitin 2005, mbetet në vlerën prej 127.932 lekësh. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

33. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare në vlerën 82.051 lekë për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2012, duke pretenduar se metoda standarde e llogaritjes së shpenzimeve për qëndrime në shtete të tjera duhet të reflektojë në rastin e qëndrimit në vende të rajonit që nuk kanë standardin e vendeve evropiane. Në

konsideratë të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, ky pretendim i subjektit vlerësohet i pabazuar.

34. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për pasurinë apartament, me sipërfaqe 110,9 m² + garazh, të ndodhur rrugën “{***}”,{***}, Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar se: *për shkak të një gabimi njerëzor, harresë e cila nuk sjell asnjë pasojë, në deklaratën vetting është plotësuar vlera sipas kontratës së sipërmarrjes, pa zbritur punimet e pakryera*. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Detyrime financiare”, ka deklaruar 4000 euro, në deklaratën e pasurisë të vitit 2009 nuk ka deklaruar vlerë të mbetur pa shlyer për këtë pasuri, ndërsa sipas procesverbalit të mbajtur në ILDKPI më datë 16.11.2011 (jo në kontekst të procesit të rivlerësimit), subjekti ka deklaruar të mbetur pa shlyer të njëjtën shumë, 4000 euro. Nga verifikimi i akteve në fashikuj, rezulton se vlera e punimeve të pakryera ka qenë 250.000 lekë, për rrjedhojë duke deklaruar vlerën e pasurisë sipas kontratës së sipërmarrjes, pa zbritur vlerën e punimeve të pakryera, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë vlerën e kësaj pasurie në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2009.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin profesional

35. Subjekti i rivlerësimit, në ankim shprehet se kundërshton në lidhje me konstatimin e Komisionit se: *gjqtarja shfaq probleme në drejtim të procedurës së parashikuar nga ligji 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, duke pretenduar se në periudhën e kontrollit të ushtruar, për shkak të volumit të madh punës, ishte e vështirë të gjente zbatim procedura e ligjit 49/2012, dhe për këtë arsye, bazuar në përvojën e saj, ka përshtatur zbatimin e procedurës civile me atë të ligjit 49/2012*. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 74 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁵⁰, si dhe të parashikimeve të legjislacionit administrativ për veprime më të shpejta dhe dobiprurëse për palët ndërgjyqëse, e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit. Në vijim, për pretendimet e tjera që subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim lidhur me vlerësimet e Komisionit për këtë kriter, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi vendimin e Komisionit, analizën dhe vlerësimet lidhur me problematikat e konstatuara prej tij (të njëjta edhe në raportin e KLD-së), nuk gjeti gabime apo problematika në drejtim të vlerësimit për këtë kriter.
36. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet dhe kërkimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, parashtrimet e depozituara përpara zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 20.04.2022, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore publike më datë 23.05.2022, si dhe pasi analizoi provat e administruara gjatë

⁵⁰ Neni 74, me titull “Aftësitë organizative”, në pikën 2 përcakton: “Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.”; dhe në pikën “3 përcakton “Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonës të akteve të nevojshme të njoftimit”.

hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues arriti në përfundimet e mëposhtme.

36.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

a) Për pasurinë “apartament”, me sipërfaqe 111 m², në Berat, subjekti i rivlerësimit:

(i) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa nuk u provua se kredia në shumën 20.000 euro, e marrë në Alpha Bank, ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie;

(ii) ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 968.360 lekë për të blerë këtë pasuri dhe për të përballuar shpenzimet familjare, përcaktuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

b) Për pasurinë “automjet”, tip “Ford Fiesta”, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e saj dhe për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2006, përcaktuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 420.185 lekë, kur në analizën financiare vlera e arredimit të apartamentit në Berat, u përllorarit sipas shifrës të rezultuar nga praktika e kredisë në ish-Bankën Popullore (aktualisht OTP Bank), dhe në shumën 52.829 lekë kur vlera e arredimit u përllorarit sipas shifrës së pretenduar nga subjekti.

c) Për pasurinë “apartament”, me sipërfaqe 110,9 m² + garazh, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me vlerën e deklaruar të blerjes së kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

ç) Lidhur me analizën financiare për periudhën 2004-2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet familjare në vitin 2005 dhe në vitin 2012, përcaktuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 314.272 lekë kur në analizën financiare të këtij viti, vlera e arredimit të apartamentit në Berat u përllorarit sipas shifrës të rezultuar nga praktika e kredisë në ish-Bankën Popullore (aktualisht OTP Bank), dhe në shumën 127.932 lekë kur vlera e arredimit u përllorarit sipas shifrës së pretenduar nga subjekti. Në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të përballuar shpenzimet familjare, në shumën 78.379 lekë.

Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, gjendet në kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë situatë faktike dhe ligjore, nuk mund të konsiderohet për aplikim parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit për sa subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas gurmës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra është rezultat i zbatimit nga Komisioni i dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit, dhe nuk vjen si pasojë e mosrespektimit të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Për pasojë, vendimi nr. 222, datë 12.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 222, datë 12.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 26.05.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi